

THE KOSOVO BANKER

Sektori bankar dhe mjedisi biznesor

Aspekte të kredisë bankare, si burim kryesor i financimit të ndërmarrjeve në Kosovë

Cilat janë arritjet dhe çka duhet bërë më tutje për zhvillimin e Sistemit të Pagesave në Kosovë?

ETIKA BANKARE

Bankat etike, ndryshe nga bankat tradicionale, nuk interesohen vetëm në potencialin e klientit për ta kthyer kredinë, e as vetëm në aspektet rregullative të kredidhënies; ato janë të interesuara në ndikimin që ky kreditim ka në zhvillimin ekonomik, në shoqëri dhe në mjedis



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKERS' ASSOCIATION

THE KOSOVO BANKER

 **Banka Ekonomike**



 **BANKA PËR BIZNES**
Mundësi për më shumë...

 **ProCredit Bank**

 **Prishtina**

 **TEB**
BNP PARIBAS JOINT VENTURE

 **Raiffeisen
BANK**

IŞBANK

ANËTAR I ASOCIUAR



Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) është zëri i industrisë bankare në Kosovë. SHBK bashkëpunon me Qeverinë, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, mediat dhe opinionin publik, me qëllim të mbështetjes së një industrie të shëndoshë bankare, e cila promovon zhvillimin afatgjatë ekonomik në Kosovë. SHBK lehtëson bashkëpunimin ndërmjet bankave, duke ofruar një platformë të vetme për lobim të përbashkët, si dhe për diskutimin e iniciativave të reja; identifi kon dhe infl uencon iniciativat ligjore dhe rregullative; koordinon bashkërendon aktivitete të përbashkëta për bankat, si dhe promovon aktivitetet bankare përpara audiencës së gjerë. Brenda SHBK-së operon Qendra për Trajtime Bankare, e cila ofron trajtime në fushën e bankave dhe të financave.

"The Kosovo Banker" është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Revista botohet dy herë në vit, me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. "Bajram Kelmendi", Nr. 15, Prishtinë; 10000, Republika e Kosovës; +381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com;

IMPRE SSUM

BORDI I DREJTOREVE

Z. Robert Wright -
Kryetar i Bordit,
Raiffeisen Bank
Kosovo

Z. Ilir I. Aliu -
Zv. Kryetar i Bordit,
ProCredit Bank

Z. Lavdim
Koshutova -
NLB Prishtina

Z. Orkun Mungan -
TEB Bank

Z. Ilir Aliu -
Banka Ekonomike

REDAKTORË

Z. Kreshnik Kosumi
Z. Blond Gerqari

THE KOSOVO BANKER
MBËSHETETET NGA FONDI
EVROPIAN PËR EVROPËN
JUGLINDORE



EUROPEAN FUND FOR SOUTHEAST EUROPE
DEVELOPMENT FACILITY

PËRMBAJTJA ✓

SISTEMI BANKAR (5-15)

■ Editoriali ■ **Sektori bankar dhe mjedisi biznesor** ■ Huamarrja e shumëfishtë dhe ndërhuamarrja: cilat janë rreziqet tuaja? ■ **Cilat janë arritjet dhe çka duhet bërë më tutje për zhvillimin e Sistemit të Pagesave në Kosovë**

KËNDI I EKSPERTËVE (16-23)

■ Aspekte të kredisë bankare, si burim kryesor i financimit të ndërmarrjeve në Kosovë ■ **Çfarë është "FATCA"?** ■ Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) nëpërmjet inovacionit ■ **Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare në rastin e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik**

KOMITETET NË SHBK (24-25)

■ Komiteti i Thesarit ■ **Komiteti i Sigurisë në Shoqatën e Bankave të Kosovës**

QENDRA E TRAJNIMEVE NË SHBK (26-27)

■ Trajnimet profesionale, si domosdoshmëri e tregut modern të punës

INTERVISTAT (28-30)

■ Afrim Gërguri
■ Shpend Nura

PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE (31-32)

■ Banka Raiffeisen në Kosovë, e përkushtuar të përkrahë aktivitete me përgjegjësi sociale ■ **Bankën Kombëtare Tregtare** ■ Disa qindra punonjës të "ProCredit Bank"-ës, pjesë e aksionit "Ta pastrojmë Kosovën" ■ **"ProCredit Bank" mbështet gjysmëmarrtonën ndërkombëtare të Prishtinës**

LAJME NGA BANKA (33)

■ Shërbimi e-banking falas, vetëm në Bankën Kombëtare Tregtare ■ **Shërbimi për depozitë të parave në bankomatët e "ProCredit Bank"-ës**

LAJME NGA SHBK(34)

■ Punëtorja "Hidrocetralet e Vogla – Mundësi për Sektorin Bankar në Kosovë" ■ **Forumi i tretë Kombëtar Shqiptar i Kartelave** ■ Konferenca "Sektori Bankar në Evropën Juglindore: Mundësitë dhe Sfidat" ■ **Panairi Financiar 2013**

KËNDI I EDUKIMIT FINANCIAR (35)

■ Punëtorja "Hidrocetralet e Vogla – Mundësi për Sektorin Bankar



Sot konsumatori juaj është në internet
E ju?

Me platformën e fundit në industrinë e reklamimit ne e sjellim mesazhin tuaj tek miliona njerëz të kyçur në internet.

Fillo sot, sepse nesër mund të jetë vonë.

038 224 093
marketing@telegrafi.com



Editorial



PETRIT BALIJA

DREJTOR EKZEKUTIV
SHOQATA E BANKAVE
TË KOSOVËS

LEXUES TË NDERUAR,

Kam nderin të ju uroj mirëseardhje në Revistën e tretë të Shoqatës së Bankave të Kosovës, "The Kosovo Banker". Për dallim nga dy numrat e parë të Revistës "The Kosovo Banker", ky numër është i dedikuar vetëm për juve duke qenë që shpërndahet me gazetën ditore, "Koha Ditore". Sikurse edhe në dy numrat e parë, numri i tretë i revistës do të vazhdojë të trajtojë tema të rëndësishme të sektorit bankar dhe atij financiar, në përgjithësi, të shkruara nga profesionistë dhe ekspertë të lëmenjve përkatës, me qëllim të informimit sa më të saktë dhe gjithëpërfshirës për ju, lexues të nderuar, informata këto të dorës së parë nga njerëz të angazhuar drejtpërdrejt në këtë fushëveprimtari. Ju dëshiroj lexim të këndshëm!



KRESHNIK
KOSUMI

SHOQATA E BANKAVE
TË KOSOVËS

Shoqata e Bankave të Kosovës ka kënaqësinë që t'ju njoftojë se në vazhden e informimit publik dhe të përpjekjeve të saj që të jetë sa më afër opinionit të gjerë publik, kësaj radhe kemi arritur të rrisim dukshëm tirazhin e revistës sonë dhe tuaj.

Në një ekonomi të hapur dhe konkurrense, në një mjedis ku mbizotëron mendimi i lirë, me perceptime të ndryshme, ne vlerësojmë se informatat, sqarimet dhe analizat e dhëna nëpërmes shkrimeve, të cilat

mund t'i gjeni në këtë numër të revistës, do të ndihmojnë dhe do të kontribuojnë në kuptimin më të mirë jo vetëm të ambientit biznesor dhe të sfidave me të cilat ballafaqohet sektori financiar, respektivisht ai bankar, por edhe të zhvillimit të gjithëmbarshëm ekonomik në vend.

Ky numër i tretë i revistës do të përmbajë shkrime nga autorë dhe ekspertë me nam, siç janë përfaqësuesi për Kosovë i Fondit Monetar Ndërkombëtar, përfaqësues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, përfaqësues të Fondit Evropian për Evropën Juglindore, si dhe ekspertë të tjerë të rëndësishëm me përvojë shumëvjeçare në sektorin bankar. Disa nga temat që do të trajtohen në këtë numër janë: Zhvillimi i sistemit të pagesave në Kosovë, Etika bankare, si dhe shkrime rreth aktiviteteve të disa prej Komiteteve, të cilat veprojnë në kuadër të Shoqatës.

Risi e këtij numri të revistës janë një sërë shkrimesh, të cilat kanë qëllim informues rreth produkteve të caktuara të sektorit bankar, e gjithë kjo në vazhden e edukimit financiar.

Në përmbyllje dëshiroj t'i falënderoj të gjithë autorët, të cilët kanë qenë pjesë e këtij numri të revistës, e këtij rrugëtimi të përbashkët dhe të cilët me kontributin e tyre e kanë pasuruar dhe më shumë përmbajtjen e saj.

ETIKA BANKARE

Bankimi etik është bankim i përgjegjshëm ndaj klientit dhe i përgjegjshëm ndaj shoqërisë.

Cfarë është bankimi etik?

Dinamika e zhvillimeve teknologjike dhe shkencore ka mundësuar që qasja në banka të bëhet përherë e më e mundshme për të gjitha shtresat e shoqërisë. Megjithatë, kjo dinamikë ka dështuar të sigurojë që afarizmi bankar të jetë i kujdesshëm dhe të vlerësojë ndikimin e tij në shoqëri dhe në ambient. Kriza e fundit financiare ka vënë në pah dëmet që bankimi i shpërkujdesur sjell dhe ka vërtetuar edhe një herë nevojën për një qasje të përgjegjshme dhe etike në sektorin financiar.

Bankimi etik që ndonjëherë haset edhe si bankim alternativ, bankim i përgjegjshëm apo bankim i qëndrueshëm, merr parasysh aspektet zhvillimore, shoqërore dhe mjedisore të financimeve që bën dhe nuk fokusohet ekskluzivisht në maksimizimin e profitit. Kështu bankat etike, ndryshe nga bankat tradicionale, nuk interesohen vetëm në potencialin e klientit për ta kthyer kredinë, e as vetëm në aspektet rregullative të kredidhënies; ato janë të interesuara në ndikimin që ky kreditim ka në zhvillimin ekonomik, në shoqëri dhe në mjedis. Thënë më thjesht, një bankë etike financon vetëm ato projekte apo qëllime që e rrisin kapacitetin e kredimarrësit për ta kthyer kredinë apo të përmirësojnë kushtet e jetesës së kredimarrësit, në njërin anë dhe që nuk kanë ndonjë ndikim negativ në shoqëri dhe në mjedis, në anën tjetër. Kështu bankimi etik shmang kredinë konsumuese, e cila jo vetëm që nuk e rrit kapacitetin financiar të kredimarrësit, por potencialisht përkeqëson atë.

Gjithashtu bankimi etik nënkupton shmangien e projekteve që mund të kenë ndikim negativ në zhvillimet shoqërore dhe në mirëqenien mjedisore. Definuar kështu, bankimi etik është bankim i përgjegjshëm ndaj klientit dhe i përgjegjshëm ndaj shoqërisë. Qëndrueshmëria e një banke është në funksion të drejtpërdrejtë të mjedisit ku ajo operon dhe vetëm një klientelë e shëndoshë dhe një ekonomi që zhvillohet siguron qëndrueshmërinë e bankës, gjë që e bën etikën bankare më shumë se një kategori morale, e justifikon atë edhe në aspektin e vepërimit thjesht pragmatik të shikuar në një horizont kohor më të gjatë se biznesi ditor.



ILIR ALIU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM NË PROCREDIT BANK KOSOVA

NËNKRYETAR I BORDIT DREJTUES I SHOQËTËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

Por, si aplikohet bankimi etik në praktikë?

Ky shkrim ka për qëllim të theksojë parimet etike bankare, zbatimin e tyre në praktikë në kuadër të shërbimeve të sotme bankare dhe ndikimin pozitiv në shoqërinë dhe mjedisin ku aplikohen.

Bankat etike iu përmbahen rregullave dhe rregullorëve të njëta sikurse bankat tradicionale. Por, përtej kësaj, bankimi etik bazohet në parime të përgjegjshme, të cilat zbatohen në kuadër të operacioneve të përditshme bankare dhe janë të inkuorpuara në secilin shërbim bankar. Kështu, parimet etike duhet udhëhequr operacionet e një banke dhe kjo është mënyra më e mirë e praktikimit të tyre.

Me qëllim të shpалosjes së një modeli sa më gjithëpërmbledhës të bankimit etik, ky shkrim bazohet në diskursin e sotëm mbi parimet etike bankare, si dhe në praktikatat e institucionit prej nga vij. Një ilustrim i tillë, në njërin anë, vë në pah debatën aktual dhe ndikimin pozitiv të bankimit etik në shoqëritë ku aplikohet, si dhe, në anën tjetër, aplikimin në praktikë të standardeve të larta etike në kuadër të operimit të një banke.

Ndër parimet etike bankare, transparenca dhe politikat e kreditimit vlerësohen të jenë ndër më domethënëset.

Transparenca

Siç përmenda, transparenca vlerësohet të jetë në krye të bankimit etik, gjë që nënkupton se një institucion ofron dhe mundëson qasje të lehtë në informata transparente për klientët dhe publikun në përgjithësi. Në këtë mënyrë, një institucion financiar është i drejtpërdrejtë dhe i hapur.

Pjesë e etikës bankare janë edhe iniciativat për ta informuar dhe për ta këshilluar publikun dhe klientët për rëndësinë që vendimet e tyre t'i bazojnë në ato shërbime bankare, të cilat nuk përkeqësojnë gjendjen e tyre financiare dhe nuk thellohen në borxhe.

Paralelisht me këtë, nga institucionet financiare



kërkohet të jenë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, duke i bazuar vendimet në analizë të shëndoshë financiare, në gjendjen ekonomike të klientëve, potencialin e bizneseve dhe kapacitetin për pagesë, në mënyrë që klientët të mund të përfitojnë nga shërbimet më të përshtatshme bankare, përfshirë kreditë.

Rëndësia e një qasjeje të tillë financiare vihet në pah edhe kur kemi parasysh përvojën e keqe aktuale të shumë shteteve në raport me kreditimin agresiv dhe çmimoret jotransparente.

Në këtë kontekst, mospromovimi i kulturës konsumuese është thelbësore. Në vend të kësaj, të promovohet kultura e kursimit dhe shërbimet bankare që iu mundësojnë individëve dhe familjarëve shtim të vlerës së investimit.

Kreditimi

Kreditimi përbën aktivitetin dominues në aktivitetin e bankave komerciale, si rezultat pesha e përgjegjësisë është e lartë në mënyrën sesi promovohet dhe zhvillohet kreditimi tek individët dhe bizneset.

Te bizneset bankimi i përgjegjshëm kujdeset të financojë projekte që kanë kthim më të lartë sesa shpenzimet e financimit dhe të këshillojnë klientët për alternativat më të mira investuese. Duke thënë këtë, bankat nuk do të duhej të promovonin kredi konsumuese, ngase konsumi sipas definicionit nuk rrit kapacitetin financiar të klientit (përkundrazi zvogëlon atë).

Të jesh institucion i përgjegjshëm bankar gjithashtu nënkupton të jesh në dijeni për ndikimin që kanë në shoqëri dhe mjedis investimet dhe kreditë. Pra, bankimi etik trajton dhe merr masa për efektet e politikave të kreditimit.

Bankat me rolin e tyre ndërmjetësues në ekonomi kanë ndikim të pamohueshëm në mjedis nëpërmes projekteve dhe bizneseve që financojnë. Ky rol tregon për potencialin e lartë të bankave në vetëdijësimin e bizneseve për ndikimin e punës së tyre në mjedis. Me lënien anash të financimeve që do të rezultojnë në dëm të mjedisit, klientët drejtpërdrejt do të bëheshin të vetëdijshëm për pasojat e aktivitetit të tyre në dëm të shoqërisë.

Prandaj, është e rëndësishme përfshirja e standardeve mjedisore në procesin e kreditimit nëpërmjet menaxhimit të riskut mjedisor, pra në kuadër të kredidhënies.

Bankimi etik përcakton standarde në lidhje me ndikimin që kanë në mjedis kreditë e lëshuara, duke i vlerësuar kreditë në bazë të kriterëve mjedisore. Me përfshirjen e çështjeve mjedisore në procesin e miratimit të kreditë, kontribuohet edhe në ndërgjegjësimin e klientelës në raport me mbrojtjen mjedisore.

Financat e gjelbra tashmë kanë zënë vend në bankimin e përgjegjshëm bankar, të cilat janë të pranishme edhe në tregun e Kosovës. Këto janë shërbime bankare të dizajnuara enkas për investime në kursimin e energjisë, investime në burime të energjisë së ripërtëritshme dhe investime të tjera ekologjikisht miqësore. Për shembull, eko kreditë lëshohen për investime për shfrytëzim efikas të energjisë elektrike, me qëllim të uljes së konsumit të energjisë elektrike dhe (ose) futjes në shfrytëzim të energjisë së ripërtëritshme.

Duke financuar investime të tilla kontribuohet në promovimin e bizneseve dhe shtëpive ekologjikisht miqësore dhe njëkohësisht stimulohet ekonomia e gjelbër në Kosovë.

Performanca e brendshme

Përveç performancës së jashtme mjedisore, bankimi etik përkujdeset edhe për performancën e përgjegjshme mjedisore përbrenda institucionit. Në fakt, bankimi etik i kushton rëndësi të njëjtë si performancës së jashtme, ashtu edhe asaj të brendshme. Këtu edhe do të specifikojë aplikimin dhe menaxhimin e një sistemi të brendshëm mjedisor, gjë që promovon performancën e brendshme të një banke në favor të mbrojtjes mjedisore. Këtu përfshihen investimet në infrastrukturën e degëve të bankës për shfrytëzim efikas të energjisë, zvogëlimin e përdorimit të materialeve të plastikë, riciklimin e letrës, e të tjera. Komponent esencial në këtë kategori është trajnimi i personelit dhe vetëdijësimi i tyre për të kursyer energji, ujë dhe letër.

Praktikuesit e etikës bankare

Debati për aplikimin sa më të gjerë të etikës bankare vazhdon. Por ajo që të gjithë pajtohen është se një bankë etike përkujdeset për ndikimin që kanë në shoqëri dhe mjedis investimet dhe afarizmi i vet bankar, duke i inkuorporuar në politikat e veta të brendshme parimet e bankimit etik. Dhe, më pas, normalisht transmetimin e politikave të tilla të përgjegjshme te personeli i vet, si bartës dhe zbatues të bankimit etik.

Sektori bankar dhe mjedisi biznesor

Ideja kryesore: shtet i ri, ndërtimi i institucioneve të reja, duke përfshirë edhe sektorin financiar, si dhe sfidat e mëdha në përdorimin e sistemit bankar si një motor për të mbështetur rritjen dhe zhvillimin e sektorit prodhues privat në Kosovë

Trendet dhe e kaluara

Kosova përfaqëson një ekonomi shumë të re, e cila përballat me sfida të konsiderueshme politike dhe sociale. Sektorin financiar i Kosovës është i dominuar nga bankat dhe është zgjeruar me shpejtësi që nga viti 2000. Aktivitetet e sistemit financiar si pjesë e Bruto Produktit Vendor (BPV) janë më shumë se të dyfishuara mes viteve 2003 dhe 2012. Bankat komerciale përbëjnë më shumë se 75 për qind të totalit të aktiveve të sistemit financiar dhe rreth 60 për qind të BPV-së. Tri bankat më të mëdha të inkuorporuara në vend janë filiale të bankave evropiane dhe së bashku përbëjnë më shumë se 70 për qind të aktiveve bankare. Një nga tri bankat e përmasave mesatare gjithashtu është në pronësi të huaj.

Sektori jobankar është i përfaqësuar nga fondet pensionale, institucionet mikrofinanciare dhe kompanitë e sigurimeve. Pas bankave, fondet pensionale janë ndër-mjetësit më të mëdhenj financiarë dhe investimet e tyre përfaqësojnë rreth 20 për qind të totalit të aktiveve financiare. Gjithashtu, janë edhe 14 institucione të vogla



JOSE SULEMANE

PËRFAQËSUES
REZIDENT I FONDIT
MONETAR
NDËRKOMBËTAR

mikrofinanciare të menaxhuara nga organizata jofitim-prurëse, të cilat nuk janë mbajtëse të depozitave. Edhe pse i vogël, sektori mikrofinanciar është huadhënësi kryesor për bizneset e vogla, bujqësi dhe familjet me të ardhura të ulëta dhe njëherësh është përgjegjës për 4 për qind të portofolit të kredisë totale të institucioneve financiare. Përfundimisht, sektori i sigurimeve është i përfaqësuar nga një kompani e sigurimit jetësor dhe 10 kompani të sigurimit jojetësor që së bashku përbëjnë rreth 3 për qind të totalit të aktiveve.

BQK-ja është mbikëqyrësi i vetëm për të gjithë ndërmjetësit financiarë. Ajo nxjerr rregulloret bankare dhe të sigurimeve, si dhe rregullat për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e fondeve pensionale. Në dritën e faktit se institucionet mikrofinanciare nuk janë mbajtëse të depozitave, ato mbikëqyren edhe nga BQK-ja.

Shtet i ri dhe institucione të reja

Kosova është shtet i ri dhe në proces të ndërtimit të institucioneve të veta të brendshme, duke ndjekur standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e mira në sektorët përkatës të veprimtarisë. Është vërtetuar se një pjesë e procesit të zhvillimit të një vendi është krijimi i institucioneve përkatëse që mbështesin konkurrencën, efika-



sitetin dhe e përmirësojnë sektorin prodhues të vendit. Në këtë drejtim, ndërtimi i institucioneve të reja është një proces në vazhdim dhe ato duhet të krijohen nga fillimi, në disa raste, dhe rrjedhimisht transformohen në rrugë e sipër bashkë me zhvillimin e ekonomisë në kornizën kohore afatmesme dhe afatgjatë.

Në kontekstin e sektorit financiar, krijimi i kornizës ligjore për stabilitetin e sektorit (ligjet e reja, ndryshimi i ligjeve ekzistuese, shndërrimi i rregulloreve të UNMIK-ut në ligje kanë rregulluar situatën aktuale të vendit) është i rëndësishëm madhore për çdo përpjekje për të përgatitur terrenin për të ardhmen. Në të njëjtën kohë ekziston nevoja për t'i trajtuar mospërputhjet në kuadrin rregullativ aktual dhe për të siguruar koherencë. Sistemi ligjor i Kosovës është zhvilluar rishtazi nga viti 2000. Për të ndërtuar shpejt kapacitetet e nevojshme institucionale, shumë institucione publike kanë marrë asistencë të theksuar teknike ndërkombëtare, në mesin e tyre edhe nga FMN-ja, e cila ka qenë një partner i rëndësishëm në këtë fushë. Për të qenë realist, marrja e ndihmës nga një gamë e gjerë e aktorëve të ndryshëm ndërkombëtarë nganjëherë mund të kërkojë më shumë bashkërendim dhe qëndrueshmëri për të rritur bashkëveprimin mes tyre dhe rolin e tyre për të mbështetur autoritetet në përpjekjet e tyre.

Në tërë këtë mjedis është e rëndësishme për t'u marrë me pjesët më kritike të sektorit financiar në zhvillim e sipër, duke marrë parasysh kapacitetet e brendshme për të absorbuar dhe për të zbatuar reforma. Në këtë kuptim, sektori bankar ka një rol të veçantë sistematik, duke marrë parasysh madhësinë dhe rëndësinë e tij për eko-

nominë dhe duke qenë se ai zë vend qenësor në axhendat e autoriteteve për hartimin e politikave dhe të reformave të tyre. Sigurisht, segmentet e tjera të sektorit financiar gjithashtu duhet të merren parasysh, siç janë: sigurimi, fondi pensional, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet jobankare.

Në kontekstin e Kosovës ekziston edhe një aspekt shtesë që duhet të merret parasysh gjatë analizës së sektorit financiar në përgjithësi, ç'gjë është e lidhur me përzgjedhjen e euros dhe implikimet në rolin e politikës fiskale dhe të reformave strukturore.

Kosova njëanshmërisht ka miratuar euron si valutë të ligjshme të saj në vitin 2002. Ndërsa kjo përkrah stabilitetin, duke ofruar një mbështetje të fortë monetare dhe përgjithësisht duke e shërbyer mirë ekonominë, ajo vendos prim mbi politikën e disiplinuar makroekonomike, i bën politikën fiskale instrument kryesor për menaxhimin e kërkesave të brendshme dhe imponon kufizime në aftësinë e Bankës Qendrore për të vepruar si huadhënëse e instancës së fundit. Në këtë drejtim, avancimi i reformave strukturore për të ndihmuar ndërtimin e një sektori të fuqishëm prodhues dhe konkurrues është i një rëndësie të madhe dhe sektori bankar ka një rol për të luajtur në drejtim të këtij objekti.

Programi i Vlerësimit të Sektorit Financiar dhe përfundimet kryesore

Në vitin 2012, autoritetet, në bashkërendim me FMN-në dhe Bankën Botërore kanë qenë të përfshira në Programin e Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP). Një

praktikë e tillë mundëson një vlerësim periodik të gjendjes së sektorit financiar dhe lë të kuptohet për nevojat e zhvillimeve të ardhshme nga masat afatshkurtra deri te ato afatgjata që duhet të ndërmerren për përmirësimin e sektorit financiar në përgjithësi.

Një nga përfundimet kryesore të FSAP-së është se, edhe pse rreziqet sistemore duket të jenë të menaxhueshme në Kosovë, ka hapësirë për cenueshmëri. Bankat e Kosovës janë të ekspozuara ndaj rreziqeve makrofinanciare për shkak të hapjes së ekonomisë, fushëveprimit të kufizuar për zgjerimin e horizonteve dhe numrit të vogël të mjeteve në dispozicion të autoriteteve për të promovuar stabilitetin makroekonomik. Pikët e dobëta janë përkeqësuar dhe më shumë për shkak të përqendrimit të tepruar në shpërndarjen e pabarabartë të ekspozimeve.

FSAP-ja ka konkluduar se struktura e ekonomisë (së vogël dhe të koncentruar) vendos disa kufizime në aftësinë e bankave për të zgjeruar rreziqet e tyre dhe kjo së bashku me adoptimin e euros vë mbrojtje të kufizuar për to, për të kompensuar kufizimet e mundshme makroekonomike. Përveç kësaj, bankat janë të cenueshme në portofolet e tyre shumë të koncentruara si dhe në rrezikun e normës së interesit.

Çështjet në rrugë e sipër

Rrjedha kronologjike e paraqitur më sipër dhe konkluzionet kryesore nga FSAP-ja hedhin dritë në disa çështje që politikëbërësit dhe menaxherët e institucioneve në sektorin financiar duhet t'u kushtojnë vëmendje gjatë ecjes përpara. E para ka të bëjë me nevojën për të zgjeruar llojshmërinë e portofoleve, ç'gjë do të thotë se politikat e qeverisë për forcimin e bazës prodhuese të Kosovës ndërtohen mbi bazat e kontributit në rritjen e gamës së asortimenteve ekonomike, përmirësimit të niveleve të të ardhurave, përparimit të aktiviteteve të sektorit publik dhe investimeve që plotësojnë dhe rrisin më shumë prodhimin e vendit.

Së dyti, Kosova është në një fazë zhvillimi në të cilën akoma vazhdon një proces dinamik në nevojë për ndryshimin e strukturës ekonomike të saj. Në këtë kontekst, duket e rëndësishme që sistemi bankar të zhvillojë instrumente, shërbime dhe produkte për të mbështetur fillimin e aktiviteteve. Sistemi bankar duhet të shkojë përtej mbështetjes apo trajtimit vetëm të kompanive ekzistuese apo të themeluara me histori krediti, që do të thotë se sistemi bankar gjithashtu duhet të mbështesë bizneset e reja për sipërmarrësit e rinj të mundshëm, që do të thotë më shumë fleksibilitet të agjentëve në sektorin bankar dhe marrje përsipër e më shumë rreziqeve, por me potencial të lartë pagimi dhe kthimi. Sigurisht,

edhe qeveria do të duhet të zhvillojë politika miqësore për biznesin dhe të krijojë nisma për lulëzimin dhe rritjen e tij. Kjo do të ishte një mënyrë nëpërmes së cilës sektori bankar do të kontribuonte në zhvillimin e sektorit privat në Kosovë.

Së treti, Kosova ka një ekonomi me një nivel relativisht të lartë jozyrtarizmi. Si të zvogëlohet jozyrtarizmi dhe si të kontribuohet në zhvillimin e sektorit financiar? Si mund të kontribuojë në uljen e jozyrtarizmit sistemi bankar? Është e rëndësishme të theksohet këtu se ballafaqimi me sektorin jozyrtar nuk duhet të trajtohet si murtajë në ekonomi, por ai sektor duhet të trajtohet brenda kornizës së hartimit të politikave të qeverisë dhe kuadrin institucional. Natyrisht, kjo ka nevojë për disa kërkime për të identifikuar më mirë politikat e duhura të brendshme dhe rrjedhimisht të aplikojë masa të përshtatshme në përputhje me rrethanat.

Së katërti, shumica e kompanive të regjistruara në vend janë në grupin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), prandaj ekziston nevoja për të lidhur zhvillimin e NVM-ve me më shumë punësim dhe të ardhura në rritje, për rrjedhojë, ç'gjë kontribuon në zhvillimin e një klase të mesme në vend dhe në zgjerimin e përmasave të tregut të brendshëm, i cili do të ndikojë në mjedisin për biznes.

Së pesti, konkluzionet e FSAP-së theksojnë nevojën për më shumë konkurrencë në sektorin bankar, si një mënyrë për të kontribuar në uljen e normave të interesit.

Së gjashti, një pjesë e ndërtimit të institucioneve të vendit dhe rritjes së bashkërendimit ndërmjet institucioneve vendëse ka nevojë për të përdorur më shumë bashkërendim dhe trajnim, në veçanti trajnimi i përbashkët i institucioneve vendëse. Një shembull i tillë do të ishte trajnimi i përbashkët mes stafit të Bankës Qendrore dhe atij të sistemit gjyqësor, duke e njoftuar këtë të fundit për çështje dhe instrumente të sektorit financiar. Një tjetër shembull edhe më i përparuar do të përfshinte mundësinë e stafit të sistemit gjyqësor për të marrë pjesë në kurset e ofruara nga sistemi bankar për stafin e tyre. Këto lloje të bashkëveprimit do të përmirësonin të kuptuarit e kufizimeve të mëdha në të dy anët dhe në këtë mënyrë do të rritej zgjidhja e çështjeve në një mënyrë më të shpejtë dhe të bashkërenduar.

Në përmbyllje, Kosova është ende në zhvillim të institucioneve të saj dhe të strukturës së ekonomisë. Në këtë proces, sektori bankar ka një rol të veçantë në nxitjen e sektorit privat të prodhimit në bashkëshoqërim me politikat qeveritare, në mënyrë që të ndihmojë ndërtimin e një ekonomie që mund të përballlet me sfidat e ekonomisë botërore.

Enti Zhvillimor i Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE DF)

Huamarrja e shumëfishtë dhe ndërhuamarrja: cilat janë rreziqet tuaja?

Sot konsumatorët gëzojnë qasje në më shumë lloje të shërbimeve të kreditit (kreditë, kartat e kreditit, mbitërheqja) nga një gamë e gjerë e ofruesve, në sajë të zhvillimit të sektorit financiar në Kosovë. Kjo do të thotë që ju mund të përdorni disa produkte të kreditit në të njëjtën kohë për të përbushur nevojat tuaja financiare, ndonjëherë edhe nga një shumëllojshmëri e ofruesve. Përdorimi i produkteve të ndryshme të kreditit nuk do të duhej, në teori, të përbëjë rrezik për ekonominë shtëpiake apo biznesin tuaj, për aq kohë sa karakteristikat e produktit të përputhen me nevojat tuaja dhe kapacitetin për t'i shlyer ato. Në praktikë, megjithatë, ju rrezikoni të ballafaqoheni me menaxhimin e pagesave të shumta, e madje edhe të gaboni rreth detyrimeve tuaja, veçanërisht nëse keni kredi të shumta nga ofrues të shumtë.

Një shikim i përgjithshëm në huamarrjen e shumëfishtë dhe ndërhuamarrjen në Kosovë

Çfarë është huamarrja e shumëfishtë? Kjo do të thotë se një klient paguan apo shlyen më shumë se një kontratë të kreditit në të njëjtën kohë. Në qoftë se këto kredi janë marrë nga institucione të ndryshme, atëherë klienti nuk është vetëm huamarrës i shumëfishtë, por gjithashtu edhe ndërhuamarrës.

Në bashkëpunim të ngushtë me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), EFSE DF ka kryer kërkime për rreziqet e huamarrjes së shumëfishtë dhe të ndërhuamarrjes, si dhe të qenit klient i mbingarkuar me borxh në Kosovë¹.

Rezultatet e studimit tregojnë se ndërsa huamarrësit (mikro) me të ardhura të ulëta zakonisht marrin vetëm një kredi, dy të tretat e huamarrësve me të ardhura më të larta kanë më shumë se një detyrim kredie². Në rastet kur klientët kanë kredi të shumëfishta, ndërhuamarrja nga institucione të ndryshme është e zakonshme – më shumë se gjysma e huamarrësve me më shumë se një kredi janë klientë të disa institucioneve.

Cilat janë pasojat e huamarrjes së shumëfishtë dhe ndërhuamarrjes?

Mos harroni se duke marrë shumë borxhe ju mund të mbingarkoheni me borxh dhe do t'ju duhet të shpenzoni shumë nga të ardhurat tuaja aktuale për pagesat mujore. Kjo gjë gjithashtu mund të ulë disiplinën tuaj të shlyerjes së borxheve, ngase është një sfidë e vërtetë për t'i menaxhuar disa afate e orare (shpesh të pasinkronizuara) të shlyerjes së borxheve.

Në fakt, të dhënat e regjistrit të kredive tregojnë se huamarrësit e shumëfishtë dhe ndërhuamarrësit janë shpesh me më shumë se 30 ditë vonesë në pagesat e tyre. Nga ana tjetër, klientët me kredi të ndryshme në të njëjtin institucion zakonisht kanë performancën më të mirë në aspektin e shlyerjes me kohë. Për shembull, vetëm 5% e klientëve me disa kredi nga i njëjti institucion janë me më shumë se 30 ditë vonesë, ndërsa ju do të kishit tri herë më shumë gjasa të jeni vonë me kredi të shumëfishta në qoftë se ato do të ishin nga ofrues të ndryshëm (shih figurën 1).


Është interesant fakti se disiplina e shlyerjes së

¹ Nëse dëshironi të mësoni më shumë sesi njerëzit marrin hua në Kosovë dhe çfarë i çon ata në mbiborxh dhe mospagesë të kredive,, lexoni përmbledhjet e studimeve të hulumtimit të kryer nga Justyna Pytkowska (Qendra për Mikrofinanca, MFC) në emër të EFSE DF-së dhe në bashkëpunim të ngushtë me Bankën Qendrore të Kosovës në vitin 2011 dhe 2012, të cilat mund t'i gjeni në www.efse.lu, në seksionin për

Studime të Përgjegjshme Financiare.

² "Mikrohuamarrësit" janë përkufizuar si klientë me kredi nën 10,000 euro; teksa dy segmentet e tjera të larta janë klientë me kredi ndërmjet 10,000 e 50,000 eurosh.

Figura 1: Performanca e shlyerjes së borxhit të huamarrësve të shumëfishtë dhe ndërhuamarrësve: % klientë me vonesa prej më shumë se 30 ditësh



borxhit për klientët me një kredi të vetme nuk priret të jetë aq e mirë sa për ata që përfitojnë një shumëllojshmëri të kredive nga një institucion. Kjo mund të jetë për shkak se ofruesit e shërbimeve financiare sigurohen që çdo produkt shtesë nuk e tejngarkon kapacitetin e klientit për të shlyer borxhet.

Pse ju do të merrni më shumë se një kredi në të njëjtën kohë?

Klientët shpesh kanë nevojë të ndryshme, të cilat mund të plotësohen vetëm me produktet e ndryshme kreditore. Bizneset marrin kredi të veçanta për investimet dhe kapitalin punues. Paradhënia mund të financojë kosto afatshkurtra ose thjesht ta qetësojë fluksin e mjeteve monetare të biznesit. Kartat e kreditit gjithashtu ju lejojnë të bëni pagesa pa të holla në dorë.

Reziku i vërtetë fillon nëse ju merrni një kredi kur tashmë jeni në mbiborxh dhe e keni problem shlyerjen e kredisë aktuale (zakonisht nga një institucion tjetër).

Kur kjo ndodh, kreditë e shumëfishta mund të zgjidhin një vështirësi të menjëhershme, por kjo do të përkeqësojë shumë problemin tuaj afatgjatë me kapacitetin e shlyerjes.

Pse do të japin institucionet kredi të reja për klientët me kredi ekzistuese?

Bankat ofrojnë një shumëllojshmëri të produkteve të kreditit për të përmbytur nevojat e ndryshme të klientëve të tyre të tanishëm. Por, ato gjithashtu përpiqen për t'i tërhequr klientët nga institucionet e tjera. Në këto raste, ofruesit e kreditit janë më të interesuar të "marrin përsipër" klientin sesa në çështjen se mos klienti është në rrezik për të mos qenë në gjendje t'i shlyejë detyrimet.

Si mund t'ju shmangeni rreziqeve që vijnë nga huamarrjet e shumëfishta dhe ndërhuamarrja?

Huamarrja e shumëfishtë dhe ndërhuamarrja është

“Studimi për mbingarkesa me borxhe i kryer nga EFSE-ja ishte i pari i bërë ndonjëherë në Kosovë dhe ishte realizuar në bashkëpunim të ngushtë me stafin e Regjistrimit të Kredive të Kosovës. Rezultatet qenë shumë të dobishme për qëllime të vlerësimit të qëndrueshmërisë së sektorit financiar. EFSE-ja ishte aq bujare sa t’ia dorëzonte metodologjinë e plotë të studimit BQK-së, e cila do të bëjë studime të tilla në të ardhmen. Rezultatet e këtyre studimeve do ta ndihmojnë BQK-në në përforcimin e mbikëqyrjes së saj të qëndrueshme në rrezik, si dhe në trajtimin e një komponenti të rëndësishëm të njohurive financiare – njohuri mbi borxhin. Pa dyshim, njerëzit do të kenë nevojë për këshilla sesi të përballen me stresin e borxhit. Dëshmitë empirike nga vende të ndryshme tregojnë se konsumatorët shpesh nuk janë të vetëdijshëm se ata paguajnë kosto të konsiderueshme për shkak të injorancës financiare.”

Gani Gërguri,
ish-gubernator i Bankës
Qendrore të Kosovës

e rrezikshme dhe mund të çojë në performancë të dobët të shlyerjes apo edhe në mbiborxh. Është e rëndësishme të ceket që Regjistri i Kredive i Kosovës jep informacion të cilësisë së lartë në kohë reale për obligimet e kreditit të individëve dhe bizneseve, në mënyrë që ofruesit e kreditit mund të kuptojnë shkallën dhe thellësinë e borxhit për secilin aplikant të kredisë. Megjithatë, vetëm për shkak se ky informacion është në dispozicion, ai jodomosdoshmërisht i parandalon institucionet financiare për t’i dhënë kredi të shumta një personi të vetëm. Ofruesit, në radhë të parë, duhet të jenë më të kujdesshëm në vlerësimin e kapaciteteve të ndërhuamarrësve për shlyerje të borxhit.

Përtej kësaj, është e rëndësishme që ju si një klient të jeni të vetëdijshëm për rrezikun e ngërthyer në huamarrjen e shumëfishtë dhe ndërhuamarrjen. Mos harroni se gjykimi i gabuar i aftësive tuaja për të menaxhuar oraret e shumëfishta të shlyerjes mund të ketë pasojë serioze.

Nëse doni t’ju shmangeni gabimeve rreth borxhit tuaj, sigurohuni që të bëni një planifikim të mirëfilltë financiar të buxhetit familjar dhe të parashikoni rrjedhën e parave të gatshme të biznesit. Kjo do t’ju ndihmojë të dini nëse të ardhurat tuaja në të ardhmen do të mbulojnë pagesat tuaja dhe ku do të mund t’i keni punët pisk. Regjistrohuni në një kurs arsimor financiar (zakonisht u ofrohet huamarrësve), angazhohuni në fushata ndërgjegjësimit dhe sigurohuni që të merrni broshurat dhe fletëpalosjet që promovojnë menaxhim dhe planifikim të mirëfilltë financiar. Ju duhet të jeni në gjendje për t’iu dalë në krye afateve tuaja kohore, duke mbajtur një kalendar të shlyerjes.

Në fund të fundit, ju dhe ofruesi juaj i shërbimit financiar duhet të punoni së bashku për t’ju ndihmuar t’i shmangeni rrezikut të marrjes sipër të një barre të madhe të borxhit. Institucioni juaj duhet t’u përmbahet politikave të përgjegjshme të kreditimit, veçanërisht në rastin e huamarrjes së shumëfishtë dhe ndërhuamarrjes. Dhe ju duhet të jeni i vetëdijshëm për rreziqet e marrjes sipër të një barre të madhe borxhi dhe të mësoni se si t’i menaxhoni financat tuaja (si shtëpiake, ashtu dhe ato biznesore) për të shmangur këto rreziqe. Mjetet që ju nevojiten për të vepruar kështu janë në dispozicion – pyesni ofruesin tuaj të shërbimit financiar për ndihmë. Duke punuar së bashku, të dy palët, ju dhe banka, do të korrni sukses!

Nëse dëshironi të mësoni më shumë sesi njerëzit marrin hua në Kosovë dhe çfarë i çon ata në mbiborxh dhe mospagesë të kredive, lexoni përmbledhjet e studimeve të hulumtimit tonë, të cilat mund t’i gjeni në www.efse.lu, në seksionin për Studime të Përgjegjshme Financiare.

Cilat janë arritjet dhe çka duhet bërë më tutje për zhvillimin e Sistemit të Pagesave në Kosovë?

Rruga e nismës, e krijimit dhe zhvillimit të një sistemi të ri të pagesave në Kosovë u shoqërua me një vullnet dhe përkushtim të madh për një të nesërme më të mirë.

Në sistemin bankar të Kosovës me efikasitet përdoren instrumente e shërbime të pagesave në mënyrë elektronike dhe realizohen rreth 23 mijë transaksione ndërbankare me vlerë prej më shumë se 26 milionë eurosh në ditë, të cilat përpunohen dhe shlyhen me sukses nëpërmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) të Bankës Qendrore.

Sot me mijëra paga, fatura e përfitime të qytetarëve të Kosovës, fatura të shpenzimeve të kompanive publike, pagesa të kompanive të sigurimeve, pagesa të Doganave të Kosovës, të ATK-së e shumë lloje e kategori të pagesave të tjera realizohen në mënyrë të shpejtë, të sigurt dhe efikase nëpërmes Sistemit të Pagesave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Ndërsa, jo shumë kohë larg nga sot, trembëdhjetë vjet më parë, filluam nga e para. Infrastruktura teknike dhe ajo legale nuk ekzistonin fare dhe kishte zero numër e vlerë të transaksioneve. Rruga e nismës, e krijimit dhe zhvillimit të një sistemi të ri të pagesave në Kosovë u shoqërua me një vullnet dhe përkushtim të madh për një të nesërme më të mirë. Kjo u arrit në bashkëpunim me *bankat komerciale*, të cilat iu bashkuan Sistemit Ndërbankar të Pagesave dhe ndihmuan kanalizimin e transaksioneve nëpërmes llogarive bankare. Ndihmë të konsiderueshme dhanë edhe institucionet qeveritare dhe në veçanti *Departamenti i Thesarit/MF*, kompanitë publike dhe ato të sigurimit, të cilat duke i besuar sistemit tonë të ri bankar kontribuan



GJYLFI DANE
KASTRATI -
KADRIJAJ

DREJTORE E SISTEMIT
TË PAGESAVE
BANKA QENDRORE
E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

njëkohësisht në standardizimin e faturave, mënyrave dhe instrumenteve të pagesave.

Filluam me një sistem të thjeshtë manual të kliringut, me shkëmbim të dy-tri urdhërpagesave në letër në mes të BQK-së (atëherë BPK) dhe dy-tri bankave komerciale që operonin fillimisht në Kosovë. Hapi i parë i rëndësishëm në këtë rrugë të inicimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të sistemit ishte kalimi në të ashtuquajturin *Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar* (SEKN), duke vazhduar me ndryshime dhe arritje të vazhdueshme, si implementimi i *Sistemit të Numrave Standard të Llogarive* në të gjitha llogaritë e sistemit bankar në Kosovë, i cili rriti ndjeshëm efikasitetin e sistemit të pagesave dhe njëkohësisht hapi mundësitë për zhvillime dhe reforma të tjera.

Në vazhden e zhvillimeve dhe arritjeve pa dyshim që ishte edhe implementimi i *Skemës së Pagesave Masive*, që u përrua me pagesat e *Administratës Tatimore të Kosovës* dhe vazhdoi me njohjen dhe zhvillimin e skemës tjetër të re të pagesave "*Kos Xhiro*". Kësaj skeme iu bashkuan Korporata Energjetike e Kosovës, Posta dhe Telekom i Kosovës, Agjencia Kosovare e Pronës, Doganat e Kosovës dhe të gjitha kompanitë e sigurimeve që operojnë në Kosovë, që e bënë këtë skemë promotor të procesimit standard të pagesave dhe automatizimit të shlyerjeve dhe bashkërenditjeve në llogari. Arritje tjetër ishte instalimi i sistemit të SEKN-së në Thesar/MF, që u pasua me

Kosova	2011	2012	Ndryshimi në %	Krahasime
BPV	4.7 mil. euro		3.8%(f)	2,650 për Kokë Banori
Vlera e transaksioneve ndërbankare	5,086 mil. euro	5,681 mil. euro	11.70%	3,129 për Kokë Banori
Llogaritë e klientëve	1,675,824	1,770,986	5.70%	98.00%
Llogaritë e-banking	68,990	97,089	40.70%	5.00%
Llogaritë me Debitim Direkt	2,159	2,750	27.40%	0.20%
Numri i kartelave	637,519	708,674	11.20%	39.00%
ATM	460	483	5.00%	266 për Mil. Banor
POS	7,534	8,592	14.00%	4,734 për Mil. Banor
Vlera e transaksioneve e-banking	218,089,663.00	1,499,093,438.23	23.10%	825.67 për Kokë Banori
Vlera e transaksioneve me kartela	965,501,131	1,077,060,401	11.60%	593.22 për Kokë Banori

standardizimin e mbledhjes së të hyrave publike "Numri Unik i Referencës, UNIREF". Vazhdimësi e arritjeve dhe zhvillimeve të mënyrave më efikase të pagesave ishte edhe implementimi i skemës së "Debitimit Direkt" për pagesa periodike me vlera të ndryshme. Mirëpo, në këtë kuadër na nevojitet ende një angazhim dhe bashkëpunim i ngushtë me bankat komerciale, me kompani të shërbimeve publike, institucione e biznese të tjera, për të gjetur dhe për të bërë të mundur rritjen e përdorimit të këtij produkti në një të ardhme të afërt. Nga kjo skemë e pagesave është pritur më shumë dhe na mbetet sfidë që të angazhohemi bashkë me banka dhe kompani për rritje të përdorimit të këtij instrumenti, përparësitë e të cilit janë të pakontestueshme.

Në tabelën në vijim shihen disa të dhëna statistikore dhe krahasime të rëndësishme për sistem të pagesave.

Vështruar nga aspekti i zhvillimeve në kuadër të Strategjisë së Zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Pagesave kemi të shtruar para vetes këto prioritetet:

- Përmirësimin e infrastrukturës teknike dhe legale/ rregullative, me qëllim të përafritimit me praktikat më të mira evropiane, për rritjen e sigurisë dhe efikasitetit dhe me synim promovimin e masës së përdorimit të instrumenteve dhe sistemeve elektronike të pagesave nga publiku.
- Promovimin e rolit katalizator të BQK-së nëpërmes bashkëpunimit ndërbankar, me qëllim të reduktimit të parasë së gatshme, kryesisht nëpërmjet përafritimit të kuadrit ligjor vendës me Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA), për shërbimet që lidhen me paranë dhe instrumentet elektronike;
- Fuqizimin edhe më të madh të rolit mbikëqyrës të sistemit të pagesave nga ana e Bankës Qendrore;

- Implementimin e Sistemit të Ri të Pagesave "Sistemi i Shlyerjeve Bruto në Kohë Reale - RTGS" si dhe përshtatjet e sistemit ekzistues të skemave të pagesave masive, Kos Giro dhe Debitim Direkt, në pajtim me standardet ndërkombëtare SWIFT 20022 dhe të SEPA-së;
- Implementimi i Sistemit të Integruar apo ndërlidhjeve shumë të sofistikuara të RTGS me Sistemin e Letrave me Vlerë, Tregun Ndërbankar, Sistemin e Llogarive të Thesarit/MF etj.
- Implementimin e Sistemit/Qendrës për Shlyerje të Transaksioneve Ndërbankare të Pagesave me Kartela;

Angazhim proaktiv të iniciativave për rritje të përdorimit të mënyrave të reja të pagesave elektronike, nëpërmes *Këshillit Kombëtar të Pagesave* dhe ekipit për menaxhim të projektit për "Reduktimit të Transaksioneve në Para të Gatshme" në Kosovë. Duke planifikuar bashkë me komunitetin bankar dhe të institucioneve qeveritare, organizime të programeve për informim dhe vetëdijësim të publikut; programe edukative dhe promovuese për shërbimet e pagesave jo kesh; publikime të fletushkave dhe materialeve për edukim financiar dhe të përgjithshëm të klientelës së bankave, etj.

Në fund vlen të theksohet se rritja e përdorimit të skemave, instrumenteve dhe shërbimeve inovative të përdorimit të skemave të avancuara të pagesave dhe parasë elektronike ndikohet jo vetëm nga siguria dhe efikasiteti i sistemeve të pagesave, shërbimeve efikase të bankave komerciale, nxitjes së konkurrencës, mbikëqyrjes, por në mënyre specifike ndikohet edhe nga stabiliteti financiar, politik dhe zhvillimi i përgjithshëm ekonomik.

Aspekte të kredisë bankare, si burim kryesor i financimit të ndërmarrjeve në Kosovë

Duke marrë parasysh mungesën e tregut të kapitalit si mundësi për financim, bankat mbesin burimi kryesor i financimit të ndërmarrjeve në vendin tonë.

Siç dihet, burimet e financimit të ndërmarrjeve janë të brendshme dhe ato të jashtme. Burimet e brendshme përfshijnë financimin nga kapitali i pronarit apo fitimet e mbajtura, kurse ato të jashtmet kanë të bëjnë me huazimet nga jashtë kompanisë (afatshkurta edhe afatgjata), përfshirë financimin nga bankat si burim i jashtëm, shumë i rëndësishëm për ndërmarrjen dhe aktivitetin e saj.

Duke marrë parasysh mungesën e tregut të kapitalit si mundësi për financim, bankat mbesin burimi kryesor i financimit të ndërmarrjeve në vendin tonë.

Është evidente se ndërmarrjet kanë nevoja financiare të ndryshme nga ato të individëve. Arsyet më të shpeshta dhe tipike që një ndërmarrje t'i drejtohet bankës për kredi janë për mjete fikse dhe mjete të kapitalit qarkullues, siç janë: Sigurimi i furnizimit me mall me afat pagese – nëpërmes Garancive apo Letër kredive; blerja e lëndës së parë, materialit për përpunim apo materialit për paketim; blerja e pajisjeve, zgjerim i aktivitetit, etj.: pagesa e shpenzimeve rrjedhëse (p.sh. shërbimet, rrogat, dogana, tatimet), etj.

Pra, një klient biznesi kërkon një kredi në mënyrë që të zgjerojë qarkullimin e vazhdueshëm të të ardhurave të tij. Këtu është edhe dallimi themelor nga kredia individuale (individët dëshirojnë t'i përdorin paratë për qëllime personale apo familjare, pa shikuar në krijimin e të ardhurave shtesë), sepse ndërmarrjet shikojnë mundësinë e multiplikimit të të ardhurave, ashtu që nga ajo pjesa shtesë e krijuar të mund të paguajnë interesin dhe borx-



AHMET ISMAILI

UDHËHEQËS I DEGËS
BANKA KOMBËTARE
TREGTARE

hin, duke krijuar edhe një fitim që më pas e rinvestojnë në ndërmarrje apo e tërheqin si dividendë.

Është shumë e rëndësishme të merren parasysh nevojat e kompanisë për mjete fikse dhe ato të kapitalit qarkullues. Në varësi të këtyre nevojave, edhe financimi duhet të jetë në përputhje me to, kryesisht në aspektin e afateve. Pra, pasuritë fikse duhet të financohen me kredi afatgjata, kurse për nevojat e kapitalit qarkullues mund të shërbejnë kreditë afatshkurta, linjat kreditore apo mbitërheqja.

Ekzistojnë forma të ndryshme të kredive për ndërmarrjet, të cilat dallojnë për nga qëllimi, maturiteti, forma e pagesës, etj. Kështu, sa i përket mënyrës së pagesës ekzistojnë kredi të cilat paguhen në fund të maturimit të tyre përnjëherë (ang. Credit Line), kredi me këste të barabarta gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, mbitërheqja (ang. Overdraft) si produkt që interes paguan vetëm për ditët që shfrytëzohet, etj. Një produkti që duhet t'i kushtohet vëmendje është po ashtu biznesi dokumentar apo financimi nëpërmes instrumenteve për sigurimin e pagesave, siç janë llojet e ndryshme të Garancive bankare apo Letër kredive, që kanë kosto më të ulët sesa kreditë dhe mundësojnë një financim efikas dhe të sigurt, veçanërisht në marrëdhëniet e eksport-importit.

Një ndër produktet kreditore që përdoret shumë shpesh, veçanërisht nga ndërmarrjet tregtare dhe shërbyese, është mbitërheqja. Në rastet kur banka ka krijuar një raport mirëbesimi dhe ka vërtetuar aftësinë paguese të klientit, mund të vendosë që klienti të mos shkojë në bankë për çdo kërkesë financiare afatshkurtë.



Në këso raste palët mund të pajtohen për mundësinë e mbitërheqjes, gjegjësisht për maksimumin deri në të cilin klienti mund të shfrytëzojë para nga llogaria e tij e biznesit në bankë nën kushte të caktuara. Normalisht ky produkt kërkon procedurë shumë strikte dhe monitorim për të qenë gjithherë në dijeni të likuiditetit të ndërmarrjes.

Zakonisht kreditë për ndërmarrje lejohen për qëllime të caktuara në bazë të planit dinamik të investimit ose planit të biznesit dhe në varësi të veprimtarisë së ndërmarrjes (si p.sh.: prodhim, tregti, shërbime, etj.). Varësisht nga natyra e aktivitetit të kredikërkuarit banka bën shqyrtimin dhe lejimin e kredisë, duke i konsideruar të rëndësishme ecuritë dhe kushtet momentale të atij segmenti në të cilin vepron klienti, sepse, siç dihet, rrezikshmëria për moskthimin e kredisë nuk është e njëjtë në të gjitha veprimtaritë ekonomike. Por, gjithashtu nga aktiviteti i ndërmarrjes varen edhe kushtet e tjera të kredisë (si: afati i kredisë, periudha e pushimit - grace period, lartësia dhe lloji i normës së interesit, etj.), të cilat aplikohen zakonisht te kompanitë prodhuese, ndërtesuese, etj., të cilat normalisht së bashku me termat e tjerë formalizohen në kontratën e kredisë me rastin e lejimit të saj. Vëmendja kryesore të kreditë për ndërmarrje përqendrohet në qëllimin e kredisë dhe aftësinë kreditore të ndërmarrjes, përkatësisht aftësinë e kredikërkuarit që të paguajë kredinë me kohë, duke realizuar njëkohësisht objektivat e saj. Është shumë e rëndësishme që rastin e financimit të ndërmarrjeve periudha e kthimit të kredisë t'i përgjigjet natyrës së investimit, por në të njëjtën kohë duhet të jetë e limituar nga kapa-

citeti pagues i kredimarrësit.

Shumica e ndërmarrjeve kanë përvojat e tyre në relacionet me bankat kredihënëse, por le ta përmendim faktin se është mjaft e rëndësishme të merren parasysh çështjet e përmendura para se ndërmarrja t'i drejtohet bankës për kredi.

Në këtë funksion duhet të merret në konsideratë fakti se në cilin stad të zhvillimit gjendet ndërmarrja, pra a është në fazën fillestare apo të rritjes, si dhe të jetë në gjendje të dokumentojë pozicionin dhe performancën financiare të vërtetë. Prandaj që banka të mund të matë aftësinë kreditore të ndërmarrjes, ajo kërkon pasqyrat financiare për periudhat e kaluara (2-3 vjet), për t'i parë arritjet e ndërmarrjes dhe për të bërë vlerësimin e gjendjes dhe performancës financiare të saj. Pasqyrat financiare të audituara janë tashmë domosdoshmëri, veçanërisht kur bëhet fjalë për financime të mëdha. Një projektion apo planifikim financiar (pro-forma) do të ishte i mirëseardhur në këtë proces, përfshirë edhe efektin që pritet të ketë financimi i kërkuar.

Duke bashkëpunuar në partneritet, klienti dhe banka duhet të kenë të njëjtin qëllim: bashkëpunimin që sjell përfitime dhe rritje të vlerës për kredimarrësin dhe të ardhura nga interesi për bankën. Humbja dhe krijimi i vështirësive nuk sjell asnjë të mirë për asnjërin palë.

Po përmendim në fund se afërsisht rreth 70% e totalit të kredive të sistemit bankar i përkasin kredive për ndërmarrjet. Prandaj, edhe roli i tillë financues i bankave është kaq i rëndësishëm për ndërmarrjet dhe synimet e tyre në një treg me konkurrencë në rritje dhe ku nevoja për investime dhe zhvillim është domosdoshmëri.

Çfarë është “FATCA”?

Ligji i Pajtuëshmërisë mbi Tatimin e Llogarive të Jashtme (Foreign Account Tax Compliance Act), tash e tutje FATCA, është legjislacioni i shkruar në mënyrë specifike për të adresuar shmangien e evazionit tatimor nga persona të SHBA-së nëpërmjet institucioneve të huaja financiare (FFI- Foreign Financial Institutions). Prandaj, qëllimi i FATCA-s është për të ndaluar evazionin e taksave nga taksapaguesit amerikanë nëpërmes përdorimit të llogarive bankare jashtë vendit (jo në SHBA). Në mënyrë që të arrihet kjo, FATCA ka krijuar një regjim të ri të mbajtjes në burim, i projektuar për të penalizuar institucionet e huaja financiare (FFI) dhe subjektet që refuzojnë të bëjnë plotësisht të ditur identitetin e personave të SHBA-së që mbajnë llogaritë me ta.

Çdo bankë jo e SHBA-së (e cila cilësohet si institucion i huaj financiar) do të ftohet të përmbyllë një marrëveshje me Shërbimin e të Ardhurave të Brendshme të SHBA-së (IRS) në kuadër të së cilës ajo pajtohet:

1. të identifikojë klientët e saj ekzistues dhe të rinj sipas procedurës për kujdesin e duhë të përshkuara nga IRS-ja,
2. të raportojë klientët e saj të identifikuar amerikanë dhe
3. të ndalë 30% të taksës mbajtëse në burim të pagesave të caktuara të bëra kundrejt:

- a. Klientëve amerikanë që nuk janë pajtuar për zbulim (klientëtkundërshtues) apo
- b. Institucioneve të huaja financiare që nuk janë në pajtuëshmëri me FATCA-n.

Ky ligj do të rrisë transparencën dhe pajtuëshmërinë e të gjithë personave të SHBA-së dhe aseteve, teksa do të ndëshkojë ashpër ata që nuk i përmbushin kërkesat e tij.

Nëse një institucion financiar që është në përputhje me FATCA-n dëshiron të shmangë zbatimin e procedurave të mbajtjes në burim, ai do të duhet të përfundojë marrëdhëniet me klientët “kundërshtues” dhe institucionet financiare që nuk janë në përputhje me FATCA-n. Për më tepër, duhet ndërtuar një proces:

- për të informuar konsumatorët e afektuar, si dhe
- për të përfunduar marrëdhënien afariste me klientët të tillë.
- Faktet kryesore për FATCA-n:
- Synimi: Mbyllja e zbrastërave për tatimim të personave që janë të tatueshëm në SHBA,
- Identifikimi i mbajtësve të llogarive dhe raportimi i të dhënave të klientëve amerikanë, duke e përfshirë bilancet e llogarive pa marrë parasysh se a



LEJLA LOXHAI

UDHËHEQËSE E EKIPIT
PËR PAJTUESHMËRI
DHE MENAXHERE E
PROJEKTIT “FATCA”
RAIFFEISEN BANK
KOSOVA

burojnë të hyrat nga SHBA-ja apo jo

- Zbulimi i personave amerikanë që zotërojnë/janë përfitues të kompanive të huaja / trusteeve, etj.
- Data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së Institucioneve të huaja financiare me IRS-në do të jetë 31 dhjetor 2013.

Potencialisht ende ekziston punë e konsiderueshme për t’u bërë për të siguruar pajtuëshmërinë, pasi që implementimi FATCA-s mund të zgjasë më tepër sesa koha e mbetur në dispozicion.


Institucionet financiare duhet të bëjnë analizë të thella për të vlerësuar ndikimin që ka FATCA mbi strategjinë e biznesit, si dhe mbi produktet dhe shërbimet që ofrojnë, klientët, procedurat dhe politikën, etj. Për të udhëhequr këtë detyrë duhet të përcaktohet një sponsor i lartë dhe të krijohet një grup punues ndërfunksional, duke i përfshirë përfaqësuesit e sektorit të shitjes, operacioneve, teknologjisë informative, financave, dhe të pajtuëshmërisë.

Institucionet e huaja financiare (FFI) duhet të jenë në pajtuëshmëri me FATCA-n!

Të gjitha Institucionet Financiare duhet të zbatojnë FATCA-n, edhe poqëse nuk kanë klientë amerikanë. Për më tepër, ato do të duhet të ndërtojnë një proces që i dëshmon IRS-së që në të vërtetë nuk kanë klientë amerikanë, përndryshe do të aplikohet 30% taksa mbajtëse në burim.

FATCA nuk do të ndikojë vetëm individët e SHBA-së!

FATCA do të rrisë dukshëm barrën e çdo Institucioni Financiar dhe disa Entiteteve të Huaja Jofinanciare (NFFE- Non Financial Foreign Entities), të cilët duhet të identifikojnë, dokumentojnë dhe të raportojnë llogaritë amerikane. Institucionet Financiare në përgjithësi do të inkuadrojnë çdo anëtar të komunitetit të investimeve dhe, siç është e hartuar



aktualisht, këtu do të përfshihen bankat (investuese/retail apo private/wholesale); mbikqyrësit e aseteve, menaxherët e aseteve, fondet, agjentët dhe kompanitë e sigurimeve. Për qëllime të FATCA-s, termi person i SHBA-së përfshin si individët privatë ashtu edhe subjektet apo entitetet.

- Individët privatë mund të përkshruhen si persona të cilët janë shtetas apo rezidentë të SHBA-së,
- Entitetet që trajtohen si persona specifike të SHBA-së përfshijnë korporatat dhe partneritetet e krijuara apo të organizuara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose sipas ligjit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe çdo pasuri apo trust tjetër, përveç pasurive të huaja apo trusteeve të huaja.

Megjithatë, duhet theksuar se jo çdo individ i identifikuar si person i SHBA-së është në të njëjtën kohë relevant për FATCA-n. Duhet bërë dallimin mes personave të SHBA-së të përcaktuar dhe personave të SHBA-së të papërcaktuar. Teksa këta të fundit janë jashtë spektrit të FATCA-s, të parët janë në objektiv. IRS-ja ka definuar disa kategori të entiteteve që janë të lira nga FATCA.

Zbulimi!

Sipas FATCA-s IRS-së duhet që t'i raportohen të dhënat personale të llogarit mbajtës amerikan si emri, adresa dhe numri identifikues i taksapaguesit (TIN), por gjithashtu do të kërkohen edhe numrat e llogarive dhe bilanci i çdo llogarie të zbatueshme, detajet mbi arkëtimet dhe pagesat brutoose tërheqjet. "Çështjet operative – Çdo informatë e mbajtur për secilin klient do të duhet të jetë e përditësuar, e plotë dhe në dispozicion në formë elektronike në mënyrë që të përputhet me kërkesat e raportimit, të cilat mund të nënkuptojnë një proces të mundimshëm të mbledhjes së të dhënave.

Çështje të pajtueshmërisë – FATCA do të rrisë nivelin e raportimit për SHBA-të që do të duhet të ndërmerret në fund të çdo viti nga Institucionet Financiare. Rreth kësaj do të ngriten çështje në lidhje mënyrën e mirëmbajtjes, mbledhjes dhe raportimit të këtyre informatave, si dhe deri në cilën pikë mund të automatizohet ky proces."

Çështjet ligjore – Republika e Kosovës ka kufizime ligjore mbi zbulimin e të dhënave personale tek qeveritë e huaja e poashtu Autoritetet e Mbrojtjes së të Dhënave Personale mund të shqyrtojnë ndalimin e përpunimit të të dhënave të kërkuara sipas FATCA-s.

FATCA kërkon që secili klient të miratojë zbulimin kur është e nevojshme dhe nëse ky miratim refuzohet, marrëdhënia afariste me klientin duhet të ndërpritet. Në këtë kontekst, dhënia e pëlqimit nga ana e 'mbajtësve të llogarive' për të hequr dorë nga rregullat e mbrojtjes së të dhënave do të mund të konsiderohej si diçka që nuk është "dhënë lirshëm". Prandaj, për të mundur që Institucionet Financiare vendëse të jenë plotësisht në pajtim me obligimet e parapara në kuadër të FATCA-s, duhet të ndryshohet dhe adaptohet legjislacioni kombëtar. Për këtë arsye shumica e vendeve të BE-së janë duke negociuar një Marrëveshje Ndërqeveritare (IGA- Intergovernmental Agreement).

Marrëveshjet ndërqeveritare (IGA)

Për të përmirësuar zbatueshmërinë e tatimit dhe për të implementuar FATCA-n, pas miratimit të saj, The-sari i SHBA-së ka publikuar dy (2) modele të marrëveshjes ndërqeveritare (IGA).

Qeveritë në Evropë dhe në mbarë botën kanë komunikuar marrëveshjet që do të zhvilloheshin dhe inicuar zhvillimin e bisedimeve për marrëveshje multilaterale të shkëmbimit të informatave për tatimim.

Rregullorja përfundimtare e FATCA-s përfshin një proces në vazhdimësi të identifikimit të llogarive amerikane, raportimit të informatave dhe tatimit e mbajtur në burim nga Institucionet Financiare.

Dallimi kryesor në mes të Modelit 1 dhe Modelit 2 të IGA-s është:

Modeli 1 i IGA-s u kërkon Institucioneve Financiare të raportojnë informatat në lidhje me llogaritë amerikane tek autoritetet tatimore vendëse, të cilat pastaj shkëmbejnë informata me IRS-në, ndërsa sipas Modelit 2 të marrëveshjes, Institucionet Financiare duhet të regjistrohen në IRS dhe të raportojnë të dhënat e kërkuara me FATCA drejtpërdrejt tek IRS-ja. Sido që të jetë, IRS-ja do të merr informata në lidhje me llogarimbajtësit amerikanë.

Një tjetër përparësi e një marrëveshjeje të tillë ndërqeveritare është se institucionet përkatëse dhe produktet të cilat paraqesin një rrezik të ulët të evazionit tatimor mund të përjashtohen në mënyrë efektive nga kërkesat e FATCA-s.

Aktualisht, Republika e Kosovës është në mesin e vendeve, të cilat nuk i kanë filluar bisedimet për një marrëveshje ndërqeveritare me SHBA-në!

Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) nëpërmjet inovacionit

Teksa faza e hershme e themelimit iu imponon NVM-ve ngritjen e një strukture të përkohshme dhe menaxhimin e sistemit në rrethanat aktuale, procesi i transformimit në një strukturë moderne të korporatës kërkon model të përparuar të zhvillimit.

Botërisht është e ditur se zhvillimi i NVM-ve është i një rëndësie madhore, sidomos për ekonomitë në tranzicion, si kjo e Kosovës. Megjithatë, në aspektin global është vërtetuar se zhvillimi i NVM-ve kushtëzohet nga mjedisi i caktuar biznesor që mund të ofrojë një vend dhe, krejt natyrisht, ky mjedis biznesor është i ndryshëm nga vendi në vend. Në anën tjetër, një numër i caktuar i faktorëve të zhvillimit qendron te vetë NVM-të, duke pasur parasysh se NVM-të janë subjekte biznesore që më së lehti u përshtaten kushteve të ndryshme, të cilat u ndihmojnë të "notojnë" nëpër ujërat komplekse dhe të gjejnë një mënyrë për hulumtim të mundësive.

Procesi i transformimit dhe i pranimit të ndryshimeve të sistemeve të zhvillimit dinamik nuk është një aktivitet i lehtë, madje as nuk është i mundur për NVM-të që nuk e ndjekin procesin normal të pranimit të këtyre ndryshimeve. Teksa faza e hershme e themelimit iu imponon NVM-ve ngritjen e një strukture të përkohshme dhe menaxhimin e sistemit në rrethanat aktuale, procesi i transformimit në një strukturë moderne të korporatës kërkon model të përparuar të zhvillimit, i cili do ta vendosë kompaninë në një nivel më të kontrolluar.

Të jesh në gjendje për ta çuar kompaninë përpara nëpërmes transformimit, si dhe për të kapur mundësitë e tregut është pikërisht çështja në të cilën duhet të përqëndrohen NVM-të në kohën kur po flasim. Në një trend tejet interesant, edhe pse i ndikuar shumë nga zhvillimi i ekonomisë së pasluftës, NVM-të tentojnë të



ARTION
CELINA

DREJTOR MENAXHUES
- KORPORATA DHE
NDËRMARRJE TË VOGLA
DHE TË MESME
TEB BANK

kopjojnë njëra-tjetër pa një analizë të thukhtë të potencialit të biznesit, të prodhimit të përgjithshëm të tregut dhe ekspertizës së nevojshme për të shfrytëzuar mundësinë e kopjuar.

Kjo qasje 'kopjo-vendos' e NVM-ve prodhon efekte të shumëfishta negative, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, me pasoja afatgjata, duke filluar nga shpenzimi i sasive të mëdha të kapitalit shumë të çmuar dhe të shtrenjtë në aktivitete që nuk do të prodhojnë kthime afatgjata, duke u mbyllur derën kështu aktiviteteve të tjera me më shumë potencial që do të mund të ishin zgjedhur, por që nuk janë vënë në jetë për shkak të mungesës së këtij investimi të veçantë. Pastaj orientimi i gabuar i fuqisë së re punëtore në ato aktivitete që nuk do të thithin njëjtë për shkak të mungesës së kapaciteteve prodhuese dhe zhvillimit të mundshëm deri në stadin e dëmtimit të marzhës së fitimit të NVM-ve ekzistuese që merren tashmë me aktivitetet e njëjta, duke i çuar ato drejt falimentimit dhe duke kontribuar në rritjen e papunësisë dhe në të gjitha efektet e tjera anësore që vijnë nga ky proces.

Kosova ka shumë më shumë potencial investimesh sesa vetëm për hapjen e një supermarketi, pishine, qendër tregtare apo restoranti. Ajo është një treg i pashkelur i shumë aktiviteteve të tjera në njësitë e shërbimit dhe të prodhimit, të cilat do të krijojnë të ardhura më të mira për aksionarët dhe një vlerë të shtuar për shoqërinë, qëllime këto përfundimtare të një subjekti biznesor. Sektorë të tillë, si tregtia e bazuar në internet apo shërbimet e specializuara dhe industritë prodhuese ofrojnë një gamë të gjerë të mundësive të biznesit që NVM-të në Kosovë duhet të marrin në konsideratë. Fuqia e re punëtore dhe një ushtri e njerëzve të papunë duhet të përdoren për një mundësi "tjetër" të biznesit që lejon kompanitë të shfrytëzojnë mundësitë e pashfrytëzuara deri tani.



Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare në rastin e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik

Furtuna ekonomike e këtyre viteve ka ndikuar në shumë aspekte të raportimit financiar, mes tyre edhe në aspektin e rëndësishëm që lidhet me zhvlerësimin e aktiveve jofinanciare. Aktivitet kryesorë jofinanciare, mbi të cilat përqendrohet ky punim, janë aktivet afatgjata materiale (AAM) dhe ato jamateriale (AAJ), e ndër të fundit edhe emri i mirë.

Pyetja që normalisht lind në çdo datë të hartimit të pasqyrave financiare është nëse ekzistojnë tregues të rënies në vlerë. Drejtimi duhet t'i përgjigjet një pyetjeje të tillë çdo vit, në momentin e hartimit të pasqyrave financiare. Një kërkesë e tillë është e detyrueshme në kuadrin e SNK 36 – "Zhvlerësimi i aktiveve" dhe rrjedhimisht edhe Standardet Kosovare të Kontabilitetit, si SKK 3 – "Patundshmëritë, impiantet dhe pajisjet". Ekzistenca e treguesve të tillë çon në detyrimin që drejtimi të kryejë një test zhvlerësimi të aktiveve afatgjata materiale. Ndërkohë që në lidhje me testimin e emrit të mirë dhe aktiveve të tjera me jetë ekonomike të dobishme të pakufizuar, kërkesa për të bërë një test të tillë në fund të çdo periudhe raportuese nuk varet nga ekzistenca e këtyre treguesve.

Pa dashur të zgjatemi në listimin e të gjithë treguesve të mundshëm të rënies në vlerë, po themi që në krye të herës "furtuna" ekonomike aktuale përbën në vetvete një tregues të fortë të mundësisë së rënies në vlerë të aktiveve të caktuara të shoqërive apo të një-

KLEDI KODRA, FCCA

AUTORI ËSHTË MENAXHER AUDITIMI ME PWC NË SHQIPËRI. EKSPERT KONTABËL I AUTORIZUAR PRANË IEKA-S DHE ANËTAR I SHOQATËS SË KONTABILISTËVE TË AUTORIZUAR TË MBRETËRISË SË BASHKUAR

ZANA SAHATQIJA

AUDITORE NË PWC, KOSOVË

sive të gjenerimit të parasë brenda totalit të aktiveve të shoqërisë.

Cilat shoqëri mund të ndikohen?

Shembuj sesi mund të influencohen shoqëritë nga kushtet e rënduara ekonomike në Kosovë dhe jashtë saj janë të shumtë. Për shembull, një shoqëri ndërtimi që kishte nisur ndërtimin e një kompleksi me apartamente banimi përpara 3 vjetësh, sot mund ta gjejë veten përballë realitetit të rënduar të rënies drastike të shitjeve dhe mungesës së financimit nga ana e bankave. Një shoqëri që ka nisur një investim të rëndësishëm në rrjetet për ofrimin e shërbimeve të internetit, telefonisë dhe televizionit mund të përballlet me realitetin e mungesës së likuiditetit dhe hezitimit të bankave për financim. Gjithashtu, mund të ndodhë që rojekti i ndërmarrë

nga kjo shoqëri të mos jetë më realist dhe të ketë nevojë, p.sh. për rishikimin e çmimeve të shitjes së produkteve, pasi vetë ngadalësimi i ekonomisë rezultoi në çmime të ulura të shitjes dhe rrjedhimisht në flukse të ardhshme hyrëse nga projekti që pritet të jenë të zvogëluara. Në një rast tjetër, një shoqëri që ka investuar në një minierë për nxjerrjen e një lënde të parë për eksport mund ta gjejë veten para realitetit të çmimeve të asaj lënde që qëndrojnë për një kohë të zgjatur në nivele të ulëta. Një rast fare fatkeq do të ishte, p.sh. nëse një shoqëri kosovare me aksionarë vendës dhe të huaj nis të investojë në një projekt në fushën e sistemit shëndetësor dhe papritmas gjendet para faktit që aksionarët e huaj nuk mund të shtojnë më kapital për shkak të vështirësive ekonomike në vendin e origjinës. Kjo shoqëri do të detyrohej të merrte hua në tregun bankar me norma interesi që janë më të larta se kostoja e kapitalit që në kushte normale do të ishte shtuar nga aksionarët e huaj. Në një situatë të tillë, megjithëse pritshmëria mbi flukset hyrëse nga projekti investues në sistemin shëndetësor vazhdojnë të mbeten pozitive, tashmë kostoja e financimit do të jetë më e lartë dhe rrjedhimisht vlera në përdorim e aktiveve të këtij projekti, e matur si Vlera e Skontuar (Aktualizuar) e Flukseve Neto të Ardhshme nga përdorimi i këtyre aktiveve do të jetë më e ulët.

Cilat janë problemet më të zakonshme të zhvlerësimeve?

Përcaktimi i normës së skontimit. Zgjedhja e normës së skontimit është një faktor i rëndësishëm në njohjen ose jo të humbjes nga zhvlerësimi. Duhet të jemi të kujdesshëm që të evitojmë përdorimin e normave të palogjikshme të skontimit; çdo ndryshim në normat e skontimit duhet të analizohet në mënyrë skeptike dhe të krahasohet me tendencat e vlerësuar në treg. Një keqkuptim i zakonshëm është supozimi se një rënie në normat e interesit të instrumenteve financiare afatshkurtra, të konsideruara pa risk (risk-free), si p.sh. bonot e Thesarit të Qeverisë së Kosovës, rezultojnë në norma më të ulëta të skontimit të përdorura në testin e zhvlerësimit. Normat risk free afatshkurtra kanë rënë ndjeshëm që nga ankandi i katërt në prill, sikurse edhe normat e risk free në afat të gjatë. Efektin kryesor në këtë ndryshim e kanë pasur rritjet në primet e rrezikut që kërkohen nga investitorët dhe në spread-et e riskut kreditor, të cilat mund të themi qëkanë qenë shumë të ndjeshme.

Për të gjetur normën e skontimit në një test zhvlerësimi këshillohet përdorimi i modelit të mesatares së ponderuar të kostonë së kapitalit (WACC). Sipas Shoqatës së Kontabilistëve të Autorizuar (ACCA) të Mbretërisë së Bashkuar, ekuacioni i WACC mund të shprehet si vijon:

$$WACC = KE (E/ E+B) + Kb (E/ E+B)$$

Në ekuacionin e mësipërm:

Ke = kosto e kapitalit (ekuiteti ose të gjitha kapitalët e veta) Kb = kosto e borxhit
E = vlera e tregut e kapitaleve të veta (ekuitetit) të shoqërisë
B = vlera e tregut e borxhit të marrë nga shoqëria.

Ekuacioni i mësipërm merr parasysh që një entitet ekonomik mund të financohet nëpërmjet 2 formave: kapitalit të aksionarëve ose borxhit. Kosto e kapitalit mund të gjendet duke përdorur modelin CAPM, ku $Ke = rf + Rm$ = norma e kthimit e pritshme nga tregu në përgjithësi.

Rf = norma e kthimit në instrumentet pa risk (risk free)

β = norma që mat ndryshueshmërinë e kthimit nga një aksion apo projekt në krahasim me kthimin që ofron tregu.

β për një aksion apo projekt/investim të caktuar mat ndryshimin e kthimit nga ky investim i krahasuar me ndryshimin në kthimin e përgjithshëm të tregut. P.sh. në varësi të industrisë nëse kthimi i pritshëm nga tregu rritet me 2%, atëherë kthimi i pritshëm nga investimi në aksionin e një shoqërie që operon brenda kësaj industrie mund të rritet me më pak se 2%, me 2%, apo me më shumë se 2%. Pikërisht këtë ndjeshmëri e mat faktori Beta. Nëse aksionet e shoqërisë Alba sh.a. kanë një β prej 1.5 kur norma e investimit me risk zero është 2%, e përfaqësuar nga bono Thesari e Qeverisë së Kosovës dhe kthimi i pritshëm nga ai treg është 13% (p.sh. në tregtinë me pakicë), atëherë kthimet e pritura nga aksionet e Alba sh.a. do të tejkalonin kthimin e pritur nga investimi me risk zero me $(13-2) \times 1.5 = 16.5\%$, pra duke e bërë kthimin e pritshëm në total nga aksionet e Alba sh.a. të jetë $(2+16.5) = 18.5\%$.

Duke parë ekuacionet e mësipërme, pavarësisht rënies së normave të kthimit mbi investime me rrezik zero, rritja e primeve të tregjeve dhe e riskut kreditor ka rezultuar në faktorë $(rm - rf)$ më të mëdhenj dhe rrjedhimisht në norma më të larta skontimi të përdorura në testet e zhvlerësimit. Një gjë e tillë është e pritshme, duke qenë se normat e skontimit kanë si qëllim të masin riskun e brendshëm të aktiveve të testuara për zhvlerësim.

Vlera në përdorim (VNP) dhe normat e skontuara para tatimit.

Për të kryer llogaritjen VNP, SNK 36 kërkon që shoqëritë të përdorin flukset e parasë para tatimit dhe një normë skontimi para tatimit. Megjithatë, në praktikë shumë shoqëri përdorin flukset e parasë pas tatimit dhe një normë skontimi pas tatimit për të përcaktuar norma VNP të njësisë së gjenerimit të parasë (NjGjP).

Megjithatë, në përputhje me standardin, shoqëritë duhet të bëjnë të ditur normën e skontimit para tatimit që është zbatuar për llogaritjen e VNP-së. Identifikimi i normës së skontimit para tatimit nuk është thjesht çështje paraqitjeje e normës bruto të skontimit pas rritjes me normën e tatimit në fuqi. Shoqëritë duhet të konsiderojnë kohën e flukseve të parasë, jetën e dobishme të NjGjP-së dhe flukset e pritshme dalëse të parasë nga taksimi.

Paraqitja

Shoqëritë që nuk njohin zhvlerësim në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse kur vlera e tregut të aktiveve të tyre është nën vlerën neto kontabël të ak-

tiveve duhet të jenë në gjendje të shpjegojnë në mënyrë bindëse pozicionin e tyre, palëve të interesuara si akcionarë, financues, etj.

Përfundim

Duke pasur parasysh ngadalësimin e aktivitetit të tregut në mënyrë të zgjatur, sidomos në industri të caktuara, pritet që shumë shoqëri të regjistrojnë humbjet nga zhvlerësimi në periudhat aktuale raportuese. Megjithatë, disa shoqëri do t'u duhet të marrin në konsideratë nëse ndonjë humbje nga zhvlerësimi, për shembull, i aktiveve afatgjata materiale ose makinerive, nga periudhat e mëparshme duhet të rimerret për shkak të ndryshimeve të papritura të favorshme që kanë ndodhur në mjedisin e tyre të operimit. Për shembull, le të themi që një shoqëri njohu një humbje nga zhvlerësimi sepse pritej që çmimi i produkteve të saj në afat të mesëm të binte. Megjithatë, tregu u zgjerua dhe tashmë ka një rritje në kërkesë (dhe një çmim në rritje) për produktet e njësisë. Në këtë rast, drejtuesve do t'u duhet të vlerësojnë nëse humbjet fillestare nga zhvlerësimi, përveç emrit të mirë, duhet të rimerren.



ARIZONA
PARTNERS

Nëna Terezë Nr. 20, kati 1
+377 (0) 45 550 015
info@arizona-partners.com
www.arizona-partners.com
10000 Prishtinë, Kosovë

● KONTABILITET

- Raportim financiar sipas IFRS dhe standardeve tjera
- Mbatja e librave kontabël
- Buxhetime
- Regjistrime kontabël
- Raportime periodike

● TATIME

- Deklarime tatimore sipas ligjeve në fuqi
- Përfaqësime në konteste tatimore
- Përgatitje dhe këshilla rreth procedurave të ATK-së

● KONSULENÇË

- Planifikim, analizë dhe vlerësim të investimeve
- Vlerësim të pasurive dhe biznesit
- Dizajnim i modeleve të kosotos së produkteve dhe shërbimeve
- Projektion financiare
- Plane biznesi
- Procedura dhe politika për kontroll të brendshëm
- Rekrutim dhe trajnim në vendin e punës për stafin e financave
- Dizajnim i modeleve për kompensime në bazë të performancës

● TRAJNIME

- Trainime specifike për provime të ACCA dhe të ngjashme
- Trainime në kontabilitet financiar dhe menaxherial
- Trainime specifike sipas nevojës

Komiteti i Thesarit: Historiku dhe zhvillimet e fundit

Komiteti i Thesarit pranë Shoqatës së Bankave të Kosovës është themeluar në vitin 2011 dhe thelbi i operacioneve dhe detyrave është plotësimi i nevojave të bankave anëtare të saj në lidhje me operacionet në tregjet financiare, themelimin dhe funksionalizimin e tregut ndërbankar, funksionalizimin e tregut të borxheve qeveritare, etj. Në këtë aspekt, Komiteti i Thesarit përpaket të ndërtojë një pozicion për të forcuar reputacionin e sektorit bankar të Kosovës si në nivel lokal, ashtu edhe jashtë vendit. Orientimi i tillë nënkupton një qasje aktive dhe kreative në të gjitha operacionet në kuadër të asociacionit, në mënyrë që të shfrytëzohet maksimalisht kualiteti i lartë i ekspertëve të fushave të ndryshme që ky institucion ka në dispozicion.

Një ndër operacionet e para të Komitetit të Thesarit ishte themelimi i tregut të brendshëm ndërmjet bankave që operojnë në Kosovë. Për shumë vjet bankat në Kosovë kishin një bashkëpunim fare të vogël me njëra-tjetrën dhe për nevojat e tyre zakonisht shfrytëzonin bankat partnere jashtë vendit. Duke e parë si një rast shumë të favorshëm për të gjithë pjesëmarrësit në treg, Komiteti i Thesarit u pajtua të themelojë një platformë elektronike për tregun e parasë në Kosovë. Objektivi themelor ishte zhvillimi i një platforme të përshtatshme të menaxhimit të informacionit në lidhje me kërkesë-ofertën për fonde likuide të bankave në Kosovë. Ajo synon të përshpejtojë qasjen në fonde në Kosovë dhe alokimin e këtyre fondeve në mënyrë sa më efektive.

Ky lloj tregu u mundëson bankave për të marrë dhe dhënë hua me norma të përcaktuara nga tregu ndërbankar. Ky lloj i kredisë në tregun e parasë zakonisht është afatshkurtër dhe mund të zgjasë deri në tre muaj, e më së shumti përdoret për të ndihmuar bankat në përmbushjen e kërkesave për rezervën e detyrueshme apo përmbushjen e indikatorëve të ndryshëm që bankat mund të kenë nga rregullat e Bankës Qendrore apo menaxhmentit të saj të brendshëm. Prej momentit të inicimit dhe funksionalizimit të këtij tregu, si dhe funksionalizimit të platformës elektronike, të gjitha bankat komerciale në Kosovë në mënyrë të vazhdueshme kanë përdorur shërbimet e ofruara dhe shpeshohet që në të ardhmen të zgjerohet gama e transaksioneve edhe më tutje, në mënyrë që edhe tregu ndërbankar të arrijë nivelet që i gjejmë në të gjitha vendet e zhvilluara të botës.

Trendi rritës i ndryshimeve në sektorin bankar të Kosovës ka ndikuar edhe në nevojën për qasje më të sofistikuar në lidhje me problemet e ndryshme.

Themelimi i tregut primar të bonove të Thesarit të lëshuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndikuar



SHPRESIM VRANOVC

KRYETAR I KOMITETIT
TË THESARIT NË SHBK

DREJTOR I DEPARTAMENTIT
TË THESARIT NË BANKËN
KOMBËTARE TREGTARE

që Komiteti i Thesarit në mënyrë aktive të japë kontributin e tij në të gjitha fazat, duke filluar nga idetë fillestare e deri në emetimin e bonove të para. Komiteti i Thesarit vazhdon të jetë aktiv në monitorimin e funksionimit të tregut të bonove të Thesarit dhe gjithashtu ofron sugjerime e vërejtje të ndryshme për funksionalizimin sa më të shpejtë të tregut sekondar, gjë që pritet të ndodhë së shpejti. Tregu i bonove të Thesarit dhe obligacioneve është një segment shumë i rëndësishëm për zhvillimin e vendit.

Bonot e Thesarit janë letra me vlerë me afat maturimi deri në 1 vit.

Bonot e Thesarit emetohen dhe garantohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ato shiten nëpërmjet ankandëve të organizuara nga Banka Qendrore e Kosovës. Bonot e Thesarit për herë të parë në Kosovë janë emetuar më 17 janar 2012 dhe janë instrumente të borxhit të brendshëm të vendit. Në Kosovë këto letra me vlerë emetohen në valutën euro dhe kanë afate maturimi 3,6 dhe 12 mujore. Pjesëmarrësit në tregun primar, sipas rregullores në fuqi, mund të jenë vetëm bankat komerciale, ndërsa individët dhe kompanitë e ndryshme mund të bëjnë blerjen e bonove të Thesarit nëpërmes bankave komerciale.

Bonot e Thesarit emetohen në formë elektronike, pra ato nuk kanë formë fizike. Evidenca në lidhje me pronësinë mbahet pranë Bankës Qendrore të Kosovës. Bonot e Thesarit shiten me discount (zbritje) ndaj vlerës së tyre nominale, që do të thotë diferenca mes çmimit të blerjes dhe vlerës nominale paraqet interesin e fituar nga kjo letër me vlerë. Në datën e blerjes investitorët paguajnë çmimin me zbritje dhe në afatin e maturimit ata marrin vlerën nominale.

Komiteti i Thesarit gjithashtu mbulon edhe fusha të tjera të rëndësishme të operacionet financiare dhe qëllimi i tij është ndërtimi i kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë në këtë fushë, në mënyrë që të lehtësohen operacionet bankare dhe të ndikojë në rritjen e zhvillimin e tyre. Shërbimet që ofrohen nga Komiteti i Thesarit janë: aktivitetet në lidhje me ofrimin e ndihmës për bankat dhe institucionet qeveritare në fushën e menaxhimit të tregut ndërbankar dhe rrezikun e ndërlidhur me këto tregje, zbatimin e standardeve ndërkombëtare të përcaktuara nga Komiteti i Bazelit për mbikëqyrjen bankare, zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, paraqitjen e funksionit të pajtueshmërisë.

Komiteti i Sigurisë në Shoqatën e Bankave të Kosovës



XHANAN KARAQA

KRYETARE E KOMITETIT
PËR SIGURI NË SHOQATËN
E BANKAVE TË KOSOVËS

DREJTORESHË E
SHËRBIMIT PËR SIGURI
NË NLB PRISHTINA SH.A.

Komiteti i Sigurisë në Shoqatën e Bankave të Kosovës (SHBK) funksionon nga viti 2009, anëtarë të së cilit janë përfaqësues të të gjitha bankave anëtare në Shoqatë që i përkasin fushës së sigurisë në sektorin bankar.

Komiteti përbëhet nga tetë anëtarë. Në kuadër të komitetit zgjidhet kryetari dhe nënkryetari me mandat njëvjeçar.

Prej themelimit komiteti mban takime të rregullta së paku katër herë në vit, e për raste të ndryshme mban edhe takime të jashtëzakonshme.

Në parim, ky komitet merret me identifikimin dhe analizën e çështjeve të sigurisë, siç janë siguria dhe mbrojtja e personave, pasurisë dhe ruajtja e konfidencialitetit të informatave në sektorin bankar, ashtu që të kontribuojë në krijimin, respektivisht përmirësimin e sistemit të sigurisë për një funksionim efikas të bankave komerciale në vend. Sfidë kjo që po i përcjell në vazhdimësi aktivitetet e këtij komiteti.

Një nga aktivitetet me të cilat është marrë komiteti është edhe rishikimi i materialeve që rregullojnë çështjet në caktuar në lëmin e sigurisë që ndërlihet me sektorin bankar.

Në mes të këtyre aktiviteteve është edhe iniciativa e marrë nga komiteti për shqyrtimin e mundësive të kyçjes së sistemit të alarmit të njësive bankare me Policinë e Kosovës (PK).

Qysh nga viti 2010 janë mbajtur një sërë takimesh, ku është diskutuar rreth draftregullores për kriteret e instalimit të sistemit alarmues të bankave dhe institucioneve të tjera në Policinë e Kosovës dhe specifikimi teknik për alarme të bankave, dokumente këto që janë përpiluar nga policia. Si fazë fillestare është diskutuar nisja e një pilotprojekti në regjionin e Prishtinës. Por, fatkeqësisht, deri më tani nuk është arritur ndonjë marrëveshje apo nuk është zhvilluar diçka më shumë në këtë drejtim, prandaj kjo çështje ka mbetur e hapur.

Komiteti ka për qëllim të mundësojë shkëmbimin e informatave mes bankave anëtare të Shoqatës dhe institucioneve të tjera të përfshira në çështje të sigurisë dhe sektorin bankar.

- Si shembull konkret i një bashkëpunimi të mirë mes bankave, e që janë anëtare të shoqatës, vlen të ceket shkëmbimi i informatave në rastet e skimming sulmeve në ATM që kemi pasur në vitin e kaluar, sulme që pothuajse i ka prekur të gjitha bankat në Kosovë. Duke iu falënderuar Policisë së Kosovës, është mundësuar prangosja e personave të dyshuar në këtë krim të organizuar, shtetas bullgarë e maqedonas.
- Pa dyshim që ka ende hapësirë për përmirësime në këtë aspekt, në mënyrë që bashkëpunimi dhe këmbimi i informatave me interes për të gjitha bankat të mos jetë i rastësishëm, por të jetë i formës së rregullt.

Edhe pse Komiteti i Sigurisë në kuadër të SHBK-së bashkëpunon me BQK-në dhe PK-në, vlen të theksohet se kërkohet një angazhim më i madh nga ana e strukturave të lartpërmendura, gjegjësisht Komiteti i Sigurisë pret përkrrahje më të madhe nga ana e tyre.

Kjo në aspektin e intensifikimit të rolit të BQK-së dhe PK-së në promovimin dhe avancimin e sigurisë në sektorin bankar dhe atë:

- Roli i BQK-së në këtë aspekt do të ishte promovimi dhe adoptimi i standardeve ndërkom-bëtare që rregullojnë fusha të caktuara në siguri, standarde këto që do të ishin obliguese për bankat komerciale që veprojnë në Kosovë.
- Ndërsa, Policia e Kosovës me krijimin e një njësie të specializuar të dedikuar për sektorin bankar, do të ndikonte në parandalimin e kriminalitetit, por edhe në rastet, si: plaçkitje, vjedhje apo thyerje, etj., me një ekip të specializuar që do të menaxhonte situatën, do të kishim një reagim më të shpejtë dhe numri i rasteve të zgjidhura do të ishte më i lartë.

Mbetemi me shpresë se të gjithë faktorët relevantë do të kontribuojnë edhe më shumë në ngritjen e nivelit të sigurisë, ashtu që bankat të ofrojnë shërbime në ambient të sigurt për klientët e saj.

Trajnimet profesionale, si domosdoshmëri e tregut modern të punës

Në vazhden e përpjekjeve të Qendrës për Trajnim Bankare pranë SHBK-së, gjatë vitit 2013 kemi pasur suksese të numërta në organizimin dhe arritjen e qëllimeve për të trajnuar stafin e sektorit bankar dhe atij financiar deri në muajin Qershor.

Ndër to vlen të përmenden trajnimet për Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar me ligjërues Robert Hall, i cili përveç njohurive në temë bartte me vete edhe një përvojë ekstensive në banka dhe financa dhe atë në shtete të ndryshme të botës. Njëzet e pesë pjesëmarrësit që ndoqën trajnimin vinin kryesisht nga bankat komerciale të Kosovës dhe nga organizatat mikrofinanciare, kryesisht nga departamentet e financave. Në fund të trajnimit tre-ditor pjesëmarrësit u ndanë të kënaqur me përmbajtjen dhe të gjitha të rejtat që i kishin mësuar gjatë trajnimit, madje disa u shprehën se kanë ardhur vetëm sa për të rinfreskuar njohuritë e tyre në temë.

Si nevojë e dalë nga komunikimi me anëtarët dhe sektorin financiar në përgjithësi, ka qenë edhe trajnimi me temë Analizat Financiare me ligjëruesin William Donovan, një ekspert nga Thesari i SHBA. Trajnimi u përcoll me një pjesëmarrje të lartë dhe aktive nga stafi i bankave, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të mësojnë edhe rreth vlerësimit të bizneseve përmes pasqyrave financiare të tyre. Trajnimi është mbajtur në termine të shpërndara në mënyrë që pjesëmarrësit të kenë mundësi të ushtrojnë mësimet e reja në punën e tyre të përditshme. Pjesëmarrësit merreshin kryesisht me punë të Riskut, Analiza dhe matje të Riskut të Kredive, Auditim dhe Kontroll të Brendshëm si dhe Financa.

Parandalimi i Shpëlarjes së Parasë dhe Financimit të Terrorizmit është trajnimi tjetër i cili u përcoll me një interesim të madh. Pjesëmarrësit vinin nga departamentet për Parandalimin e Shpëlarjes së Parasë si dhe nga departamentet e BQK-së për mbikëqyrje të bankave, sigurimeve dhe mikrofinancave. Eksperti flaman i njohur në mbarë Evropën në këtë temë, Marco Zwick, i udhëhoqi pjesëmarrësit nëpër trajnim duke



ARBEN SALIHU

MENAXHER I TRAJNIMEVE
SHOQATA E BANKAVE TË
KOSOVËS

analizuar aspekte dhe raste praktike dhe duke i krahasuar këto përvoja me legjislacionin e Kosovës për Parandalim të Shpëlarjes së Parasë dhe Financimit të Terrorizmit.

Në muajin qershor, stafi i bankave në shërbim të klientëve ndoqën trajnimin për Shërbim të Klientëve me qasje nga Inteligjenca Emocionale. Ligjëruesja Florentina Dushi, psikologe dhe konsulente me përvojë në fushën e Zhvillimit të Organizatave, i udhëhoqi pjesëmarrësit nëpër trajnim duke i udhëzuar që të kenë parasysh aspektet emocionale kur komunikojnë me klientët dhe si ti zbatojnë ato në raste të ndryshme. Pjesëmarrësit u shprehën shumë të kënaqur pasi se për herë të parë kanë dëgjuar rreth aspekteve emocionale dhe tipareve të personaliteteve të ndryshme të njeriut.

Ndërkohë 15 kandidat janë në përfundim e sipër të kursit përgatitor për Certifikimin Bankar EFCB, të cilët do t'ju nënshtrohen testit gjatë muajit korrik. Pjesëmarrësit gjatë 110 orëve të kursit përgatitor kanë mësuar rreth Politikave Monetare të BE-së, Bankës Qendrore Evropiane, rreth klientëve të ndryshëm të bankave dhe nevojat e tyre të ndryshme për financim, Menaxhimin e Thesarit, Menaxhimin e Riskut, Mikrofinancat, Etikën, Marketingun, Burimet Njerëzore dhe Menaxhimin e Përgjithshëm në Banka. Të gjithë kandidatët që kalojnë testin e certifikimit do të marrin certifikatat e lëshuara nga European Banking and Financial Services Training Network (EBTN) ku Shoqa-



ta e Bankave të Kosovës është institucion i akredituar dhe anëtare e asociuar. Certifikatat vlejnë në të gjitha shtetet e Evropës dhe disa shtete tjera të botës.

Prej muajit Shtator e deri në fillim të vitit 2014 Qendra për Trajnime Bankare në SHBK ka planifikuar një sërë trajnimesh dhe certifikimesh me prioritet për sektorin e të cilat gjithashtu do të mbahen nga ekspertët më të kërkuar të lëmive përkatëse.

- Certifikimi PCI DSS (Payment Card Industry Data Security Standards) do të certifikoj stafin e bankave për standardet ndërkombëtare të ruajtjes së të dhënave nga kartat dhe ju ofron njohuri për praktikën më të mira se si aplikohen këto standarde sigurie.
- Basel II ka për qëllim që të njoftoj kandidatët për rregullativin e dalë nga Komiteti i Baselit dhe implikimet në bankat tona, duke pasur parasysh se Republika e Kosovës e ka përparuar këtë rregullativë dhe po e zbaton në sistemin tonë.
- Aftësi të Avancuara Negocimi është trajnim i cili ka për qëllim t'u jap kandidatëve njohuri më të thellë rreth specifikave dhe aspekteve të ndryshme të negociimit. Programi është duke u përpiluar së bashku me ekspertë me përvojë të gjatë dhe të suksesshme ndërkombëtare në negociim.
- Menaxhimi i Riskut Operacional do të mbahet nga fundi i këtij viti dhe do të përmbaj procedurat dhe rregullat se si më së miri menaxhohet Risku Operacional, si mitigohet ky risk, implikimet e teknologjisë dhe të natyrës njerëzore në gabimet operacionale. Trajnimi mbështetet nga Banka Botërore në kuadër të projektit për Asistencë Teknike Financiare.
- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore në kuadër të programit 3 ditor përmban nocione, praktika dhe raste studimi për një ndër shkaqet kryesore të suksesit të një biznesi e që janë Burimet Njerëzore. Trajnimi mbështetet nga partneri i SHBK-së nga Luksemburgu Agjencioni për Transferim të Teknologjisë Financiare (ATTF).
- E-banking do t'ju ofroj pjesëmarrësve njohuri se si të përdoret teknologjia për shërbime bankare dhe si kanal distribuimi për bankat, aspektet me rëndësi për rrezikun dhe sigurinë e të dhënave si dhe si po kalohet gradualisht nga shërbimet direkte në shërbime elektronike.
- Në Tetor, të gjithë individët e interesuar të bëjnë karrierë në banka apo të promovohen në pozita më të larta, do të kenë mundësinë të ndjekin kursin përgatitor dhe të Certifikohen në EFCB që është njëri ndër certifikimet bankare më të pranuar ndërkombëtarisht.

Trendet aktuale të zhvillim



ËSHTË ARRITUR TË RUHET BILANCI MES SIGURISË DHE TË BËRIT BIZNES

AFRIM GËRGURI

UDHËHEQËS I NJËSISË SË OPERACIONEVE,
DEPARTAMENTI I KARTELAVE DHE BIZNESIT ELEKTRONIK
PROCREDIT BANK

1) Sa është niveli i sigurisë me kartelat bankare?

Bankat në Kosovë kanë bërë investime të shumta në teknologji, duke implementuar sisteme shumë të avancuara të sigurisë në sektorin e kartelave, si dhe në përgjithësi për shërbimet elektronike.

- Në këtë aspekt kanë ndikuar disa faktorë specifikë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

- Bankat në Kosovë kanë filluar të operojnë me kartela në kohën kur kjo industri ka marrë hov të madh zhvillimi dhe në këtë mënyrë janë aplikuar platformat më të avancuara. Gjithashtu bankat kanë qenë shumë të kujdesshme në aspektin e sigurisë, duke evituar produkte dhe metoda që do të ishin lehtë të keqpërdorura.

- Përfundimisht deri tash është arritur të ruhet bilanci mes sigurisë dhe të

bërit biznes, duke ruajtur dhe duke siguruar vetë klientët.

- Një fakt tjetër që ka ndikuar në nivelin e sigurisë së kartelave bankare ka të bëjë me rregulloret dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë, për të cilat ne obligohemi që t'i aplikojmë. Pra, përveç rregullatorit qendror, gjegjësisht Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat janë të licencuara nga sistemet ndërkombëtare të pagesave VISA dhe MasterCard dhe operojnë duke iu obliguar rregullave dhe standardeve të tyre.

- Madje, krahasuar me regjionet e tjera, këto standarde për vendin dhe regjionin tonë janë shumë më strikte si nga niveli i teknologjisë, ashtu dhe në aspektin e rregulloreve të përgjithshme.

- Bazuar në këto argumente, zhvillimi i industrisë së kartelave dhe

shërbimeve të tjera elektronike bankare në Kosovë përcillet me nivel shumë të lartë të sigurisë.

- Megjithatë, që prej fillimit të kësaj industrie kemi të vetëdijshëm për ekzistimin e tendencave për keqpërdorim nëpërmes skemave të ndryshme.

- Shfrytëzuesit e kartelave gjithashtu kontribuojnë dhe kanë rol kyç në nivelin e sigurisë. Klientët nëpërmes shfrytëzimit korrekt të këtyre produkteve plotësojnë dhe kompletojnë hallkën e sigurisë.

- Në industrinë e kartelave kjo ka rëndësi të veçantë dhe është e njohur si aplikimi i "praktikave më të mira".

2) Çfarë ka bërë banka juaj për të parandaluar mashtrimet e mundshme?

"ProCredit" është banka që ka lëshuar kartelat e para bankare në Kosovën

e pasluftës, më saktësisht që nga fillimi i vitit 2002, kur edhe ngritëm Qendrën e Procesimit dhe Personalizimit të Kartelave.

- Që atëherë "ProCredit Banka" aplikon sisteme shumë të larta të sigurisë të bazuara në teknologji dhe standarde të avancuara.

- Suksesi ynë në parandalimin e skemave eventuale të mashtrimeve është arritur duke u përqendruar në disa drejtime, të cilat paraqesin strategjinë tonë:

- Shfrytëzimi, përcjellja e teknologjive të avancuara dhe trajnimet profesionale.
- Jemi implementuesit e parë të teknologjisë '3D Secure' në Kosovë - për transaksione në internet me iPIN ose fjalëkalim,
- Implementimi i sistemeve shtesë të sigurisë që përfshijnë detektimin dhe parandalimin,

nit në sistemin bankar

“Duke mos lënë anash asnjëherë përcjelljen e teknologjive dhe standardeve të reja të sigurisë është shumë e rëndësishme ngritja e nivelit të bashkëpunimit në mes të institucioneve, përfshirë projekte dhe programe të përbashkëta informimi dhe edukimi për opinionin publik, duke i angazhuar mediet elektronike dhe ato të shkruara.”

- Standardet dhe praktikat më të mira të veprimit,
- Informimi, edukimi dhe bashkëpunimi me klientët,
- Koordinimi me palët e tjera, ndër të cilat është bashkëpunimi në kuadër të Shoqatës së Bankave (Forumit kundër mashtrimit me kartela), VISA&MasterCard, bashkëpunimi me organet kompetente të sigurisë dhe ligjit, media, etj.

3) Çfarë mund të bëhet në të ardhmen që të minimizohen rastet e keqpërdorimeve me kartela?

Duke mos lënë anash asnjëherë përcjelljen e teknologjive dhe standardeve të reja të sigurisë është shumë e rëndësishme ngritja e nivelit të bashkëpunimit në mes të institucioneve, përfshirë projekte dhe

programe të përbashkëta informimi dhe edukimi për opinionin publik, duke i angazhuar mediet elektronike dhe ato të shkruara.

- Duhet theksuar se bashkëpunimi me organet e sigurisë (njësitë kompetente të Policisë) është në nivel shumë të mirë, i kurorëzuar me raste të suksesshme të parandalimit të mashtrimeve.

- Në kuadër të Forumit kundër mashtrimeve me kartela, në Shoqatën e Bankave edhe këtë vit planifikojmë të organizojmë trajnime për gjyqtarët dhe prokurorët, për informim dhe njohuri të reja nga fusha e sigurisë së kartelave. Besojmë që këto korrespondenca do të ndihmonin që rastet eventuale të trajtohen sa më mirë dhe kështu vendimet e gjykatës të kenë ndikim edhe më të madh në luftën kundër këtyre mashtrimeve.

- Në përgjithësi duhet vazhduar punën në ngritjen e nivelit të vetëdijesimit për të gjithë pjesëmarrësit në biznesin e kartelave, me theks të veçantë te klientët dhe publiku i gjerë.

- Klientët, qoftë individë, qoftë kompani, është shumë me rëndësi të jenë të njohuar dhe të vetëdijshëm për përgjegjësinë në kryerjen e një pagese.

- Kjo jo vetëm për ruajtjen e të dhënave 'sensitive' të produkteve bankare, por edhe për metodat e përdorimit dhe trajtimit të kartelave apo pajisjeve të tjera elektronike.

- Prandaj është shumë me rëndësi njoftimi dhe informimi i klientëve për rrezikun nëse një mjet pagese (p.sh. kartelë) nuk ka kujdesin e veçantë dhe nuk përdoret sipas rregullave të sugjeruara nga banka.

- Le të marrim një shembull të thjeshtë një shtëpi

e siguruar me të gjitha teknikat e mundshme të sigurisë. Por, nëse i zoti i saj lë çelësin te dera për ta përdorur kushdo, atëherë si mund të flitet për sigurinë e saj?

- Në shumë raste çelësi i suksesit në parandalimin e mashtrimeve dhe keqpërdorimeve është aplikimi i praktikave më të mira për shfrytëzimin e kartelave nga vetë klientët (realizimin e transakcioneve).

- Prandaj bashkëpunimi i ngushtë dhe i ndërsjellë në mes të të gjitha palëve është vendimtar për një strategji suksesi.

- Si përfundim, kartelat dhe produktet e tjera elektronike kanë vlera dhe mundësi të avancuara në krahasim me paranë e gatshme, ku gjithsesi aspekti i sigurisë është çdo herë në anën e kartelave dhe shërbimeve elektronike.



30.000 EURO PA PASUR NEVOJË QË BIZNESI TË JETË I REGJISTRUAR

SHPEND NURA

UDHËHEQËS I SEGMENTIT TË BIZNESEVE TË
VOGLA, RAIFFEISEN BANK

1) Cilat janë kriteret e përgjithshme për aplikim për një kredi bujqësore?

Kriteret e përgjithshme për aplikim për kredi bujqësore janë mjaft të thjeshta dhe fleksibile. Kërkohej që aplikuesi të jetë banor legal i Kosovës, të ketë veprimtarinë aktive në Kosovë, të referohet në ndonjërin nga pikat e "Raiffeisen Bank" dhe në bashkëpunim me zyrtarin për kredi bujqësore fillon procesin e aplikimit, ku plotësohen shënimet për aplikuesin dhe lista e pengut (pajisje pune, mallra, etj.). Kreditë bujqësore mund të financohen deri në 30.000 euro pa pasur nevojë që biznesi të jetë i regjistruar, kurse mbi këtë shumë kërkohej të jetë i regjistruar si biznes në Kosovë.

2) Sa është koha / afati i maturimit për një kredi bujqësore?

Afati i maturimit për kredi bujqësore është deri në 84 muaj, kryesisht me kreditë afatgjata financohen investimet kapitale, blerja e pajisjeve, ndërti-

mi i objekteve, etj. Ndërsa me kredi afatshkurtra kryesisht financohen blerja e mallit, mbjelljet sezonale, varësisht nga kërkesat e klientëve.

3) Sa është grejs perioda (grace period) për kreditë bujqësore?

Për rastet e pagesave në bazë të sezonit, ofrohen periudha pushimi deri në 12 muaj. Kjo është një mundësi e mirë që shfrytëzohet nga veprimtaritë që kanë shitje vetëm në sezon të caktuara të vitit dhe ekziston mundësia e përshtatjes së plotë të kërkesës së aplikuesit.

4) Cilat janë sfidat që bizneset i hasin në lidhje me kreditë bujqësore?

Natyrisht që në ambientin dhe rrethanat që karakterizojnë tregun ku veprojmë, ekzistojnë sfida të ndryshme për bizneset. Ne në vazhdimësi jemi përkushtuar të ofrojmë përkrahje për tejkalimin e tyre.

Disa nga sfidat që mund t'i përmendim janë mbulimi me kolateral, mungesa e shënimeve për shitjet, garantimi i tregut, sigurimi në rast dëmtimeve nga fatkeqësitë natyrore, etj.

5) Cili është bashkëpunimi i bankave me institucione për zhvillimin e bujqësisë?

"Banka Raiffeisen" në Kosovë ka pasur një bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjitha institucionet e vendit dhe me ato ndërkombëtare sa i përket zhvillimit të bujqësisë. Me këtë rast do të doja të përmend bashkëpunimin e vazhdueshëm me shoqatat e ndryshme që përfaqësojnë bujqit, drejtoritë komunale dhe në veçanti dëshirojmë të potencojmë marrëveshjen e fundit me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural dhe me USAID-in, marrëveshje kjo që drejtpërdrejt do të ndikojë në përkrahjen edhe më të madhe të sektorit të bujqësisë në Kosovë.



Banka Raiffeisen në Kosovë, e përkushtuar të përkrahë aktivitete me përgjegjësi sociale

Në strategjinë e Bankës Raiffeisen pjesë përbërëse është edhe Përgjegjësia Sociale e Korporatës. Banka Raiffeisen si qëllim të saj e ka të jetë bankë e përgjegjshme, partner i drejtë dhe korporatë e përkushtuar për qytetarët kudo që banka operon. Fokusimi në përkrahjen e projekteve dhe organizimeve të ndryshme e ka dëshmuar që përkushtimi i bankës është serioz dhe i vazhdueshëm.

Projektet e përkrahura nga banka kanë karakter gjithëpërfshirës dhe janë në fusha, si: edukimi, kultura, sporti dhe mirëqenia sociale. Një ndër projektet e përkrahura nga Banka Raiffeisen në Kosovë është edhe projekti ATOMI, i realizuar nga Qendra për Studime dhe Shërbime Psikologjike dhe Sociale "EN-COMPASS". Projekti ATOMI ka për qëllim identifikimin e nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme. Gjithashtu, projekti ka mbulueshmëri në të gjitha shkollat e mesme të Kosovës dhe të drejtë aplikimi kishin të gjithë të interesuarit. Implementuesit e projektit me teste të njohura ndërkombëtarisht e bënë filtrimin e nxënësve, kur prej të gjithë aplikantëve u përzgjedhën 50 më të mirët. Për nxënësit e dalluar ishte përgatitur edhe shkolla verore, ku nxënësit

patën rastin të mbanin takime, work shope me profesorë të lëmenjve të ndryshëm me interes për ta. Në një takim ishin edhe kolegët e Bankës Raiffeisen, ku mbajtëm një prezantim lidhur me Burimet Njerëzore, temë e përzgjedhur bashkërisht me implementuesit e projektit. Përveç shkollës verore, për nxënësit e dalluar ishte paraparë edhe monitorimi i tyre dhe orë konsulence për nevojat e tyre.

Bashkëpunimi me Qendrën ENCOMPASS dhe Bankën Raiffeisen po vazhdon edhe në edicionin e dytë të projektit. Qëllimi i Bankës për të mbështetur të rinjtë dhe edukimin e tyre do të mbetet në qëllimet e saja kryesore.



Përgjegjësia shoqërore, prioritet i vazhdueshëm i BKT-së

Për Bankën Kombëtare Tregtare përgjegjshmëria sociale ka qenë dhe mbetet një prioritet i saj i vazhdueshëm. Si rezultat i kësaj banka në vazhdimësi ka zhvilluar projekte të lidhura me mjedisin dhe komunitetin, në mënyrë që të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë dhe ndërgjegjësimin e saj për ruajtjen e ambientit.

Konceptit të Bankës Kombëtare Tregtare për përgjegjshmërinë sociale në bazë të motos “Kontribuo për shoqërinë” i ka shërbyer ofrimi i produkteve dhe shërbimeve cilësore, krijimi i mundësive për punësim, sponsorizimi i vazhdueshëm i aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive dhe atyre të edukimit.

BKT-ja ka tre vjet që është sponsor gjeneral i Superligës së Basketbollit të Kosovës, pjesëmarrëse dhe sponsor i disa mbrëmjeve gala, fondet e grumbulluara të cilave kanë shkuar në dobi të fëmijëve të sëmurë, sponsor i Shoqatës së të Verbërve, sponsor i arsimimit të fëmijëve me rezultatet më të larta në kolegjin “Mehmet Akif”, sponsor në përkrahje të nismës “Ta pastrojmë Kosovën”, etj.

Rritja gjithnjë e më e madhe e BKT-së në Kosovë, e cila aktualisht operon me 24 degë, bazohet në qëllimin e saj strategjik që të bëhet banka numër një në ofrimin e produkteve financiare, duke vazhduar rritjen e pjesëmarrjes në treg, mbajtjen e pozicionit lider në shumëllojshmërinë e produkteve, teknologjive të reja, strategjive inovative dhe interesave të ofruara.

Disa qindra punonjës të “ProCredit Bank”-së, pjesë e aksionit “Ta pastrojmë Kosovën”

“ProCredit Bank” ka pranuar me entuziazëm ftesën e iniciativës qytetare “Ta pastrojmë Kosovën”, duke pastruar hapësira publike në të gjitha qytetet e Kosovës ku operon banka.

Disa qindra punonjës të bankës kanë mbushur qindra qese me mbeturina, duke dhënë mesazhin që një ambient i pastër është përgjegjësi e gjithsecilit.

“ProCredit Bank” mbështet fuqishëm idenë e kësaj iniciative se hedhja e mbeturinave në vendet e duhura dhe ruajtja e ambientit janë përgjegjësi e secilit prej nesh.

Për të dytin vit me radhë kemi pasur kënaqësinë që bashkërisht si ekip i “ProCredit Bank”-së të japim kontributin tonë qytetar për një Kosovë me ambient më të pastër dhe të përcjellim mesazh vetëdijesimi që ta mbajmë pastër vendin tonë.

Urojmë që lokacionet të cilat i pastruam sivjet të



transferohen në hapësira të pastra publike, siç ishte rasti i vitit të kaluar. “ProCredit Bank” vitin e kaluar në Prishtinë ka pastruar parkun në Arbëri dhe te hekurudha.

Për dallim, sivjet ne i kemi ndarë mbeturinat e mbledhura në plastikë, kanaqe dhe letër.

Po ashtu, “ProCredit Bank” ka ndihmuar këtë nismë mjedisore edhe në përhapjen e mesazhit që të gjithë së bashku më 24 maj të dalim dhe ta pastrojmë lagjen, fshatin, qytetin, vendin tonë.

Kontributi i “ProCredit Bank”-së për një ambient të pastër dhe të gjelbër është një ndër shtyllat kryesore të përgjegjësisë sonë shoqërore dhe vlerë e integruar në punën tonë.



“ProCredit Bank” mbështet gjysmëmaratonën ndërkombëtare të Prishtinës

Me moton “Vrapo për paqe dhe tolerancë”, Prishtina për të dymbëdhjetin vit me radhë ishte mikpritëse e gjysmëmaratonës ndërkombëtare më 12 maj 2013. “ProCredit Bank” është mbështetëse tradicionale e kësaj ngjarjeje të rëndësishme sportive në vend, e cila kontribuon në imazhin e sportit kosovar. Më shumë se 860 garues kanë marrë pjesë në gjysmëmaratonën e këtij viti.

Lajme nga Bankat

E-BANKING
PA PAGESË

Vetëm në BKT ju kurseni kohë dhe para me shërbimin dega "Internet"

BKT
Banka Kombëtare Tregtare

030 900 900 | www.bkt-ks.com

Shërbimi E-Banking | BKT-së ofrohet falas për të gjithë klientët bankë, individë dhe të biznesit.

Aktivizimi | lehtë nga cilado degë e BKT-së, si dhe çasje direkte në qdo kohë, në www.bkt-ks.com

Ne jemi gjithmonë këtu

Shërbimi e-banking falas, vetëm në Bankën Kombëtare Tregtare

Banka Kombëtare Tregtare, duke parë tendencën në rritje të vazhdueshme të përdorimit të e-banking-ut, si kanal mbështetës për kryerjen e transaksioneve bankare në ditët e sotme, ua ofron klientëve të saj këtë shërbim falas dhe me cilësinë më të mirë të mundshme.

Nëpërmjet këtij shërbimi Banka Kombëtare Tregtare iu mundëson klientëve të saj të kryejnë një pjesë shumë të madhe të nevojave të tyre bankare nga shtëpia, pa pasur nevojë të shkojnë fizikisht pranë ndonjë dege të bankës dhe të humbasin nga koha e tyre e vlefshme.

Me anë të këtij shërbimi klientët individualë mund të hapin llogari, të kontrollojnë historikun e saj, të hapin depozita, të përcjellin depozitat e tyre, të shikojnë historikun e kredive të tyre (afatin, këstin, normën e interesit, etj.), të bëjnë këmbimin valutor në monedha të ndryshme, të përcjellin kursin e këmbimit, të bëjnë transfere mes llogarive personale, mes llogarive të ndryshme të BKT-së dhe mes llogarive të bankave të tjera në Kosovës, të marrin informacion rreth kartave të tyre të kreditit, të bëjnë pagesën e detyrimit të kartës, të marrin paradhënie nga karta e kreditit në llogarinë e tyre rrjedhëse, të aplikojnë për kartë krediti, të bëjnë lid-

hjen e kartës së debitit me llogaritë e tjera personale, të marrin informacion rreth kartave të debitit, të kenë mundësinë për të vendosur dhe për të ndryshuar informacionin mbi kontaktin (e-mail adresë) si dhe të ndryshojnë informacionet personale (adresën e vendbanimit).

Ndërsa për bizneset shërbimet që ofrohen janë: transfere brenda BKT-së, hapje depozitash, transfere te bankat e tjera në Kosovë, transfere brenda llogarive të veta në BKT, veprime me valutë (blerje, shitje valute), hapje llogarish si dhe gjenerim pasqyre llogarie.

Shërbimi e-banking ofrohet falas vetëm në BKT për të gjithë individët dhe falas deri në muajin shtator për bizneset.

Shërbimi për deponim të parave në bankomatët e "ProCredit Bank"- së

Deponimi (Cash in) në bankomat është shërbimi më i ri nga "ProCredit Bank", i cili iu mundëson klientëve

që nëpërmjet bankomatit të deponojnë lehtë dhe shpejt para në llogaritë e tyre rrjedhëse 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, duke mos u kufizuar as gjatë vikendeve dhe festave.

Deponimi në bankomat lehtëson menaxhimin e të hollave dhe e tëra që nevojitet është që klienti të posedojë

kartelë debiti nga "ProCredit Bank".

Ky shërbim ofrohet në bankomatët të cilët janë të vendosur në këndet "Shërbehu vetë", brenda degëve të bankës.



Punëtorja “Hidrocentralet e Vogla – Mundësi për Sektorin Bankar në Kosovë”



Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC) ka organizuar punëtorinë me tematikë “Hidrocentralet e Vogla – Mundësi për Sektorin Bankar në Kosovë” me datën 29 maj 2013. Pjesëmarrës në takim

ishin përfaqësues të bankave komerciale në Kosovë, këshilltarë, prezantues dhe të tjerë nga Korporata Financiare Ndërkombëtare.

Në punëtorinë e organizuar me këtë rast u prezantuan produktet e shërbimeve këshilluese dhe të investimeve të Korporatës Financiare Ndërkombëtare të cilat janë zhvilluar për të mbështetur bankat në financimin e projekteve për energji të rinovueshme.

Në përfundim të punëtorisë u vlerësua se investimet në energji të ripërtërishme paraqesin një fushë të re investuese për sektorin me mundësi të mëdha në zhvillimin ekonomik të vendit.

Forumi i tretë Kombëtar Shqiptar i Kartelave



Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me Komitetin Kundër Mashtrimeve me Kartela ka marrë pjesë në Forumin e tretë Kombëtar Shqiptar të Kartave të organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave. Forumi ka zhvilluar

punimet e saj me datën 17 maj 2013 në Tiranë, me tematikë: “Drejt një të ardhme dinamike të biznesit”. Pjesëmarrës në Forum ishin përfaqësues të bankave komerciale në Shqipëri dhe Kosovë, Banka e Shqipërisë, Visa dhe Master Card, policisë nga Shqipëria dhe Kosova si dhe përfaqësues të tjerë të cilën ofrojnë shërbime në fushën e teknologjisë informative.

Këtë vit Shoqata e Bankave të Kosovës është përfaqësuar përmes prezantimit të bërë nga zt. Modest Morina në cilësinë e Kryetarit të Komitetit Kundër Mashtrimeve me Kartela që për përmbajtje të saj kishte zhvillimet e fundit që janë bërë në industrinë e kartelave në Kosovë.

Në përgjithësi në Forum është bërë një analizë e gjendjes së tregut, shkëmbim i përvojave ndërmjet dy vendeve si dhe sfidat me të cilat priten të ballafaqohen në të ardhmen.

Në fund Forumi u vlerësua si një vend shumë i mirë ku mund të diskutohen dhe shkëmbehen përvojat, vlerësohen mënyrat më të mira të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve brenda vendit dhe jashtë saj, si dhe si një mënyrë shumë e mirë që ndihmon në parandalimin e keqpërdorimeve dhe në uljen e ekonomisë informale përmes nxitjes në përdorimin sa më të madh të instrumenteve elektronike të pagesave.



Konferenca “Sektori Bankar në Evropën Juglindore: Mundësitë dhe Sfidat”

Shoqata e Bankave të Kosovës ka marrë pjesë në konferencën rajonale të organizuar nga Shoqata e Bankave Turke në Stamboll me datën 8 Maj 2013, me tematikë “Sektori Bankar në Evropën Juglindore: Mundësitë dhe Sfidat”. Pjesëmarrës në këtë ngjarje ishin guvernatorët e bankave qendrore nga Turqia, Shqipëria, Maqedonia, Bosnia dhe Hercegovina, Serbia dhe Kosova si dhe përfaqësues të shoqatës së bankave nga vendet lartçekura.

Në konferencë të gjithë pjesëmarrësit prezantuan zhvillimet e fundit që janë bërë në vendet respektive të tyre në fushën e sektorit bankar që për përmbajtje kryesore kishte mundësitë që ofrojnë vendet e këtyre shteteve si dhe sfidat me të cilat ballafaqohen ato. Në konferencë Kosova u përfaqësua përmes prezantimit të zt. Gërguri i cili vlerësoi se Kosova megjithëse një shtet i ri i formuar, ajo ka një qëndrueshmëri të mirë financiare me një rritje ekonomike të qëndrueshme vjetore dhe si një treg i ri me një ekonomi të hapur paraqet mundësi të mirë për investime të huaja.

Panairi Financiar 2013



Panairi Financiar është një ndër ngjarjet më të rëndësishme për sektorin financiar. Ky panair organizohet me qëllimin që të mbledhë ekspozues që kanë të bëjnë me veprimtarinë financiare dhe sektorin bankar, si dhe pjesëmarrës apo vizitorë me

prapavijë të ndryshme. Panairi Financiar iu mundëson bankave dhe institucioneve tjera financiare që të prezantojnë produktet e tyre dhe të komunikojnë me klientët, vendimmarrës, media dhe investitor të ndryshëm. Pjesën kryesore të këtij panairi, përveç ekspozimit, e përbëjnë edhe konferencat e ndryshme që organizohen në kuadër të panairit, të cilat përfshijnë tema shumë të rëndësishme, me ç'rast ekspertë të ndryshëm diskutojnë për çështje të sektorit bankar dhe për ekonominë në përgjithësi. Panairi Financiar për vitin 2013 planifikohet të mbahet në shtator. Interesimin tuaj për pjesëmarrje mund ta paraqisni përmes e-mailit: panairifinanciar@bankassoc-kos.com.

BPV

BPV apo Bruto Prodhimi Vendor është vlera totale e të gjitha produkteve dhe shërbimeve që prodhohen apo shiten brenda një shteti të caktuar dhe në një kohë të caktuar. Bruto Prodhimi Vendor ka rëndësi jetike për një shtet, sepse e tregon nivelin bazë të një shteti dhe është indikator i suksesshëm i ekonomisë së një shteti të caktuar. BPV mund të kalkulohet në tri mënyra, e ato janë:

1. Metoda e prodhimit,
2. Metoda e shpenzimit dhe
3. Metoda e të ardhurave.

BPV matet çdo vit dhe bëhet rinfreskimi i informatave për çdo vit. Shpeshherë është metoda e shpenzimit që përdoret për matjen e BPV-së, ndërsa formula e saj është si në vijim:

BPV = Konsumi privat (C) + Bruto investimet (I) + Shpenzimet e qeverisë (G) dhe Net eksportet (eksportet-importet), që automatikisht sjell në formulën:

$$GDP=C+I+G+NX$$

Në tabelën e mëposhtme janë 15 shtetet me BPV-në më të fuqishme.

1	Shtetet e Bashkuara	\$ 15,660,000,000,000	2012 est.
2	Bashkimi European	\$ 15,630,000,000,000	2012 est.
3	Kina	\$ 12,380,000,000,000	2012 est.
4	India	\$ 4,784,000,000,000	2012 est.
5	Japonia	\$ 4,525,000,000,000	2012 est.
6	Gjermania	\$ 3,123,000,000,000	2012 est.
7	Rusia	\$ 2,504,000,000,000	2012 est.
8	Brazili	\$ 2,362,000,000,000	2012 est.
9	Mbretëria e Bashkuar	\$ 2,323,000,000,000	2012 est.
10	Franca	\$ 2,253,000,000,000	2012 est.
11	Italia	\$ 1,834,000,000,000	2012 est.
12	Meksika	\$ 1,761,000,000,000	2012 est.
13	Korea Jugore	\$ 1,611,000,000,000	2012 est.
14	Kanadaja	\$ 1,446,000,000,000	2012 est.
15	Spanja	\$ 1,409,000,000,000	2012 est.
16	Indonezia	\$ 1,212,000,000,000	2012 est.
143	Kosova	\$ 13,560,000,000	2012 est.

Burimi: CIA World FactBook, <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook//rankorder/2001rank.html>

“Rregulla e nr. 70”

“Rregulla nr. 70” tregon vitet në të cilat një shtet specifik mund ta dyfishojë rritjen e vet ekonomike. Në fakt, “rregulla nr.70” tregon se për sa vjet mund të dyfishohet BPV e një shteti, duke u bazuar në rritjen aktuale ekonomike. P.sh., Kosova ka një rritje ekonomike prej 4% në vit. Nëse do të dëshironim të dinim se për sa vjet ekonomia e Kosovës do të dyfishohej, thjesht do të merrnim numrin 70 dhe do të pjesëtonim me rritjen aktuale ekonomike që është 4%; (70/4), Kosova do të arrinte të dyfishonte ekonominë e vet për 17 ose 18 vjet.

Bazat e Afarizmit Bankar | EFCB

*European Foundation
Certificate in Banking*



fitoni njohuri dhe certifikatë bankare

krijoni vetes përparësi gjatë rekrutimit në banka

përfitoni nga certifikata e njohur ndërkombëtarisht

Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit,
kontaktoni Qendrën e Trajnimeve në Shoqatën e Bankave të
Kosovës:

- 038 246 171
- kbatraining@bankassoc-kos.com
- www.bankassoc-kos.com



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKERS' ASSOCIATION

THE KOSOVO BANKER
MBËSHTETET NGA FONDI
EVROPIAN PER EVROPËN
JUGLINDORE

